

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7648 E martë 11 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në "Reporter.al"

Mediat serbe e kanë përshkruar fjalimin "historik" të Aleksandër Vuçitit në Kosovë të dielën si "momentin e tij Gazimestan", diçka e ngjashme ...
Vijon në faqen 20

Nga MILOS CIRIC

Fjalimi i Vuçitit në Kosovë promovoi një fantazi të rrezikshme



Opinion i Ditës

Asnjëherë zgjedhjet parlamentare në Suedi nuk janë pritur me aq interes dhe shqetësim sa ato të datës 9 shtator. Sepse gjatë 100 viteve të fundit ...
Vijon në faqen 21

Nga JORGJI KOTE

'Jo'-ja suedeze ndaj ekstremizmit



"Mirëpresim vendimin për amendimin e ligjit"

Komisioni Europian: "Teatri i ri" nuk bie ndesh me MSA, por duhet garë e hapur

Veliq: Një lajm i shkëlqyer, pengesat ranë.
Jorida Tabaku: KE i dha të drejtë opozitës

Nga VALENTINA MADANI

Komisioni Europian përmes një letre drejtuar qeverisë shqiptare dha dje dakordësinë e tij për amendimin e ligjit për teatrin, por njëkohësisht kërkoi nga qeveria një garë të hapur e transparente, duke ftuar edhe aktorë ...
Në faqen 4-5

DEMSHPERBLIMI/ MINISTRIA E FINANCAVE PUBLIKON LISTEN E TRASHEGIMTAREVE

ISH-TE PERNDJEKURIT, EMRAT E 650 PERFITUESVE

Ish-të dënuarit politikë që marrin këstin e dytë financiar. Dokumentet dorëzohen në Drejtorinë e Pagesave. Afati për plotësimin e dosjes, 3-muaj



(Në foto) Ish-të përndjekur politik

UDHEZIMI

Mundësi për të studiuar në SHBA, ambasada: Ja si duhet të aplikoni
Në faqen 10

MEMALIAJ

Vranë kushëririn me plumb në kokë, gjykata lë në qeli babë e bir
Në faqen 12

FITON SKOCIA 2 - 0

Shqipëria nuk kalon dot në "Hampden Park", ngel me 3 pikë
Në faqen 22

INTERVISTA



Flet 22-vjeçari me hemofili: Ka mungesë sasive të ilaçeve që marrim

Në faqen 11


Dy partitë e opozitës konfigurojnë trupën e përbashkët të deputetëve për platformën "anti-krim"

Vetingu në politikë, grupet e punës PD-LSI

Taulant Balla: Basha bën propagandë, SPAK do hetojë gjithkënd

NGA DARINA TANUSHI

Socialistët e kanë cilësuar "të dëshuar" propozimin e bërë nga kryetari i PD-së, Lulzim Basha për veting të politikanëve. Në mbledhjen e Grupit Parlamentar të PS-së, drejtuar nga kryetari Taulant Balla u shpreh qëndrimi se



PS është për veting të vërtetë, atë që e bën reforma në drejtësi. Burimet nga mbledhja e grupit bënë të ditur se Balla u ka thënë deputetëve se kjo nismë është një perçje mbi reformën në drejtësi, ndërkohë që SPAK dhe BKH sigurojnë vetingun ...
Në faqen 2

INTERVISTA

Daljana Sejdia: Në "News 24" ndihem sikur jam në një familje të madhe
Suplement

VETINGU NË POLITIKË REAGIMET

Mungon Rama, Grupi i PS përjashton deputetin e Kurbinit, Gjetani

Darina Tanushi

Socialistët e kanë cilësuar "të dështuar" propozimin e bërë nga kryetari i PD-së, Lulzim Basha për veting të politikanëve. Në mbledhjen e Grupit Parlamentar të PS-së, drejtuar nga kryetari Taulant Balla u shpreh qëndrimi se PS është për veting të vërtetë, atë që e bën reforma në drejtësi. Burimet nga mbledhja e grupit bënë të ditur se Balla u ka thënë deputetëve se kjo nisje është një perçje mbi reformën në drejtësi, ndërkohë që SPAK dhe BKH sigurojnë vetingun e politikës në shkallë shumë të gjerë. Edhe sipas një sqarimi që u është dhënë deputetëve socialistë, PS do të qëndrojë në këto pika kundërshtimi për propozimin e Bashës: "SPAK dhe BKH nuk kalojnë në sitë thjeshtë lidhjet e politikanëve me krimin (ndërkohë që propozimi i Bashës është një sitë për thashethemet mbi krimin), por mbi të gjitha pasuritë dhe të ardhurat e tyre; SPAK dhe BKH nuk ndalojnë vetëm tek politikanët (ndërkohë që propozimi i Bashës ndalon vetëm tek thashethemet mbi politikanët), por edhe tek pasuria e të ardhurat e familjarëve të tyre". Sipas dokumentit shpërndarë për deputetët, "SPAK dhe BKH nuk mjaftojnë vetëm me largimin e politikanëve të lidhur me krimin nga politika (siç parashikon propozimi i Bashës për lidhjen e thashethemeve me politikanët), por garantojnë që ndaj politikanëve të korruptuar dhe të lidhur me krimin, merren masa ndëshkuese deri edhe me burgim". "Nisma e Bashës është e dështuar edhe si propagandë politike pasi të gjithë e kuptuan menjëherë që përtej propagandës s'kishte veting të politikës po politikë me vetingun, ndërkohë që përmes SPAK dhe BKH vetingun e politikës nuk e bëjnë vetë politikanët apo disa "kukulla" të zgjedhur prej tyre, por organet e pavarura të drejtësisë dhe institucionet kushtetuese, të monitoruara nga BE dhe SHBA. "Pas muajsh përpjekje për të ndaluar reformën në drejtësi dhe ngritjen e SPAK dhe BKH, tani që institucionet kushtetuese janë në prag të nisjes së vetingut real të politikës, Lulzim Basha vjen me një propozim që ka qartësisht qëllim propagandistik, me një "gjoja" veting që: a. Bëhet nga vetë politikanët për veten e tyre; b. Nuk merret me pasurinë e politikanëve; c. Nuk merret me familjarët e politikanëve; d. Nuk merret me dënimin e politikanëve të korruptuar apo të lidhur me krimin.

Vetingu i politikës, Balla: Basha bën propagandë, SPAK heton edhe familjarët

Dokumenti me 3 argumentet kundër propozimit të PD



Kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla

EDI RAMA

Kryeministri Edi Rama është nisur për një vizitë në Shtetet e Bashkuara. Ende nuk dihet një axhendë e vizitës së tij, por pritet që ai të rikthehet në Tiranë në mes të javës, për të qenë i pranishëm në seancën e Kuvendit, ditën e enjte.

ARGUMENTET E GRUPIT TË PS KUNDËR PROPOZIMIT TË BASHËS

1. Nisma e Bashës është cungim i reformës në drejtësi. SPAK dhe BKH sigurojnë vetingun e politikës në shkallë shumë më të gjerë:
 - a. SPAK dhe BKH nuk kalojnë në sitë vetëm lidhjet e politikanëve me krimin (siç parashikon propozimi i Bashës), por edhe pasurinë dhe të ardhurat e tyre;
 - b. SPAK dhe BKH nuk ndalojnë vetëm tek politikanët (siç parashikon propozimi i Bashës), por edhe të familjarët e tyre;
 - c. SPAK dhe BKH nuk mjaftojnë vetëm me largimin e politikanëve të lidhur me krimin nga politika (siç parashikon propozimi i Bashës), por sigurohen që ndaj politikanëve të korruptuar dhe lidhur me krimin merren masa ndëshkuese deri edhe me burgim.
2. Nisma e Bashës është autovetëveting i politikës, ndërkohë përmes SPAK dhe BKH vetingun e politikës nuk e bëjnë vetë politikanët apo disa "kukulla" të zgjedhur prej tyre, por organet e pavarura të drejtësisë dhe institucionet kushtetuese, të monitoruara nga BE dhe SHBA.
3. Pas muajsh përpjekje për të ndaluar reformën në drejtësi dhe ngritjen e SPAK dhe BKH, tani që institucionet kushtetuese që do të kryejnë vetingun e politikës janë gati për të nisur nga puna, Basha vjen me një propozim për të dobësuar SPAK dhe BKH dhe për t'i zëvendësuar ato me një "gjoja" veting që:
 - a. Bëhet nga vetë politikanët për veten e tyre;
 - b. Nuk merret me pasurinë e politikanëve;
 - c. Nuk merret me familjarët e politikanëve;
 - d. Nuk merret me dënimin e politikanëve të korruptuar apo të lidhur me krimin.



Gjatë një seance parlamentare

Partitë jo parlamentare: Zgjedhjet e 2019-ës të bëhen me Kodin e ri Zgjedhor

Partitë politike jo parlamentare kërkojnë dje, që zgjedhjet vendore të 2019 të bëhen sipas Kodit të ri Zgjedhor. Në një tryezë të përbashkët, këto parti kërkojnë që kjo reformë të jetë transparente dhe gjithëpërfshirëse dhe të udhëhiqet nga prezenca e OSBE-së. Në tryezën e drejtuar nga bashkëkryetarët Koço Kokëdhima i Partisë Zgjidhja dhe Arben Tafaj i Partisë Agrare, ky i fundit u shpreh: "Do të synojmë përsëri në aleancat e partive të mëdha, ne e dimë dashamirësinë e tyre, vullnetin dhe gjithë hilet që përdorin. Apo do të kemi aleatët tanë ndërkombëtarë, sikurse Shqipëria në historinë e vet i ka pasur këto aleanca, Amerikën dhe OSBE". Këto forca politike kërkojnë që në kodin e ri zgjedhor të garantohej votimi dhe numërimi elektronik, gjë që sipas tyre do të çlirohte zgjedhjet nga partitë e mëdha që i kanë marrë ato peng. "Ne nuk dëshirojmë që të vazhdojë monopoli i partive të vjetra mbi zgjedhjet, administrimin e zgjedhjeve. Ne dëshirojmë që administrata zgjedhore të jetë apolitike dhe të drejtë e gjithë partive mbi procesin zgjedhor të jenë të barabarta", tha Kokëdhima. 20 subjektet jo parlamentare insistuan që reforma zgjedhore të përfundojë para zgjedhjeve vendore të vitit 2019, ndërsa theksuan se është kusht themelor që Shqipëria të marrë një përgjigje pozitive për hapjen e negociatave.

Manja: opozita të japë kontribut në bërjen e ligjeve, të vijë në Kuvend

Në mungesë të deputetëve të opozitës Komisioni i Ligjeve zhvilloi seancë dëgjimore me 9 anëtarët që garojnë për Komisionin e Pavarur për Monitorimin e Organeve të reja të reformës në drejtësi. Kreu i komisionit, Ulsi Manja tha se "edhe kolegët e opozitës do të duhet të ishin të pranishëm". "I ftoj që të japin kontributin e tyre në mbledhjen e radhës të komisionit do të përzgjidhen 5 anëtarët që do të kalojnë më pas për votim në parlament. Detyra e këtij institucioni të ri do të jetë monitorimi i zbatimit të reformës në drejtësi. Gjatë diskutimeve në komisionin e mazhorancës të korruptuar apo të lidhur me krimin", sqarohet nga PS.

"Deri më sot strategjia e Lulit ka qenë përbalja me libër shpie e kundërshtarëve të tij. Siç e tha dhe kryeministri, ne jemi gati për një veting me libër shpie që të marrë fund një herë e mirë

ra-noës u shprehën se brenda këtij sesiioni parlamentar duhet që të përmbillen 27 ligjet e reformës në drejtësi. Këtu, kryetari i komisionit i bëri thirrje edhe opozitës që të japë kontributin e saj. "Na presin shumë projektligjet të rëndësishme përpara. Në objektivin e punës së këtij komisioni është përmbijllja e paketës së 27 ligjeve të dyta të paketës së dytë të reformës në drejtësi. Konkretisht, në axhendën e punës së këtij komisioni do të jenë gjashtë projektligjet e fundit të kësaj pakete". Z. Manja, ndër projektligjet e rëndësishme për shqyrtim nga komisioni

renditi edhe ndryshimet në Kodin Penal si nisje e 37 mijë zgjedhësve dhe projektligjin për iniciativën ligjvënëse të shtetasve shqiptarë. "Komisioni i Ligjeve do të vijojë të ushtrojë, si deri më sot, edhe funksionin e tij kontrollues në lidhje me institucionet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj, që janë në sferën e përgjegjësisë së këtij komisioni dhe natyrisht nuk do të ngelet jashtë punës së komisionit në këtë sesion parlamentar edhe funksioni i tretë, jo më pak i rëndësishëm, funksioni zgjedhës, që ka komisioni i ligjeve për ato institucione dhe për ato organe, që

janë në sferën e përgjegjësisë së komisionit për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut", tha Manja.

do të bëjnë edhe vetingun e politikës të mos ndalet",-u shpreh Balla. Ndërkohë dje, në mbledhjen e grupit parlamentar është votuar për përjashtimin e deputetit të Kurbinit Gjetani Gjetani, ndërsa kryeministri Rama mungoi për shkak të vizitës në SHBA.

9 KANDIDATËT

1. Andi Murataj
2. Artan Spahiu
3. Gëzim Allaraj
4. Ilir Kadriu
5. Irena Mino
6. Saimir Shehrru
7. Sajmir Vishaj
8. Suzana Pasha (Hoti)
9. Lindita Rujsmajli



Vetingu i politikanëve, Basha në Gjermani, të enjten opozita në Durrës

Platforma antikrim, PD-LSI katër grupe të përbashkëta pune

Ekspertët nisin sot nga puna me "komisione paralele"

Valentina Madani

Opozita do të bojkotojë sërish të enjten punimet e Kuvendit. Pas Shkodrës e Elbasanit, deputetët e partive opozitare do të mbledhen në qytetin e Durrësit për të vijuar denoncimin e lidhjeve, që sipas saj qeveria ka me krimin. Demokratët kanë ngritur katër grupe për të pasuruar me propozime konkrete platformën për çlirimin e qeverisjes nga krimi, ku nisma për vetingun në politikë është një ndër 4 shtyllat e dokumentit të përbashkët opozitar. Platforma e opozitës parashikon dekriminalizim i plotë përmes vetingut të politikanëve të lidhur me krimin; çlirimin e drejtësisë nga kapja politike në funksion të bashkëqeverisjes së Edi Ramës me krimin; zgjedhje të lira të ndershme dhe një ekonomi e çliruar nga monopolet, oligarkët dhe nga korrupsioni qeveritar. Pak ditë pasi propozoi veting në politikë, kryetari i PD-së, Luzlim Basha, udhëtoi djeg drejt Gjermanisë për një vizitë njëditore, për takime në Bundestag. Basha do të flasë me faktorin politik gjerman mbi situatën politike dhe platformën e opozitës, ku përfshihet vetingu në politikë, drejtësia, zgjedhjet e lira dhe ekonomia e çliruar nga monopolet. Për këtë çështje u diskutua edhe në mbledhjen e grupit parlamentar, ku u vendos ngritja e 4 grupeve pune me deputetë dhe ekspertë të fushës, ndërsa deri të mërkurës do të hartohet një dokument i plotë. Grupet e punës do të hartojnë për çdo shtyllë të platformës politike një dokument strategjik, i cili më pas do të diskutohet dhe prezantohet për qytetarët. Pas mbledhjes së dëshme është marrë vendimi për të filluar punën dhe në Kuvend. Sipas burimeve mësohet se grupet e punës së opozitës do të jenë sot në Kuvend, jo në Komisionet Parlamentare, por për të nisur nga puna "komisione paralele". Mësohet se të katër grupet do të kenë dhe takime me median, për të bërë të ditur platfor-mën e tyre në mënyrë më të detajuar.



Mbledhja e Grupit Parlamentar të PD-së

DOKUMENTI

Pas mbledhjes së dëshme është marrë vendimi për të filluar punën dhe në Kuvend. Sipas burimeve mësohet se grupet e punës së opozitës do të jenë sot në Kuvend, jo në Komisionet Parlamentare, por për të nisur nga puna "komisione paralele". Mësohet se të katër grupet do të kenë dhe takime me median, për të bërë të ditur platfor-mën e tyre në mënyrë më të detajuar.

FLAMUR NOKA

"Vetingu i politikanëve do bëhet. Balla, Xhafaj, Çyrbja do t'i bashkohen Ben Nokës, Roshit, Frrokut e të tjerëve si ata. Njësoj si për dekriminalizimin, Edi Rama ka filluar propagandën kundër, por kjo është përpëlqitje e kotë. Politika do të ndahet një herë e mirë nga krimi dhe bashkëpunëtorët e krimi", shprehet deputeti i PD-së.

Vasili, akuza qeverisë: Çlirimi i vendit nga krimi, një sfidë pa kthim

Kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili shprehu dje bindjen se çlirimi i vendit nga krimi është një sfidë pa kthim. Sipas tij, qeveria përballë krimi është lakuriq dhe vë përpara si gjethe fiku drejtësinë e kapur. Po ashtu, Vasili shprehet se çlirimi i vendit nga krimi është një sfidë pa kthim dhe pa ndalim. "Rilindja tani po përdor gërmadhen e drejtësisë së mbetur për t'u futur në brekushet e saj. Pasi kapën kryeprokuroren, vetingun, pasi futën si anëtarë të KLGJ dhe KLP lloj e soj personazh pa integritet, të refuzuar edhe nga ONM; pasi shkatërruan Kushtetutën e 21-22 korrikut, pasi shkrinë Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë, pasi lanë vendin pa KLGJ dhe KLP, rilindja dhe të sajët menduan se ia hodhën. Lufta pa asnjë kompromis me krimin dhe me ata që e përfaqësojnë atë në krye të qeverisë është vija ndarëse për çdo qytetar, analist e politikan me integritet dhe që e do vendin. Kushdo që do të rreket të bënte alibinë e krimi për shkak të mëditjes erëkeqe të qeverisë do të ishte as më shumë dhe as më pak se sa një me shumë pas gjetes së fikut të qeverisë", - tha z. Vasili.



Deputeti i PD publikon foton: Radhët e gjata tek ambasada gjermane

Deputeti demokrat, Bardh Spahia publikoi dje disa foto që tregojnë qytetarët në dyert e ambasadës gjermane. Spahia shkruan se shqiptarët duan të lënë Shqipërinë, duke iu referuar mesazhit të një qytetari që po pret gjithashtu tek ambasada gjermane. Qytetari i bën thirrje kryeministrit Edi Rama të kalojë nga ajo rrugë. "Shqiptarët mësynjë dyert e ambasadave me synimin e vetëm: të lënë Shqipërinë. Tek ambasada gjermane rikthehen radhët e gjata, këto pamje menduam se i kishim lënë pas. Mesazhi i mëposhtëm nga një qytetar: Z.Bardhi tregoji pak kësaj qeverisë se çfarë bëhet tek ambasada gjermane. Thuaji Ramës hajde pak nga kjo rrugë e shiko realitetin e vërtetë të popullit", shprehet deputeti i PD-së.

VETINGU NË POLITIKË, GRUPE TË PUNËS PD-LSI, 4 KOORDINATORËT

- 1 - Dekriminalizimi i plotë përmes vetingut të politikanëve të lidhur me krimin.
 - PD
 - Ervin Salianji
 - Oerd Bylykbashi
 - Rudina Hajdari
 - Isuf Çela
 - Xhemal Gjunkski
 - Klevis Balliu
 - LSI
 - Petrit Vasili
 - Klajda Gjoshja
 - Kejdi Mehmetaj
 - Endrit Brahimllari
- 2 - Çlirimi i drejtësisë nga kapja politike që të ndëshkojë dhe jo mbrojë bashkëqeverisjen e Edi Ramës me krimin:
 - PD
 - Enkelejd Alibeaj
 - Gent Strazimir
 - Flamur Noka
 - Aldo Bumçi
 - Dhurata Çupi
 - Astrit Veliaj
 - Lindita Metaliaj
 - LSI
 - Silva Caka
 - Nasip Naço
- 3 - Zgjedhje të lira të ndershme, demokratike ku qytetarët të jenë ata që vendosin:
 - PD
 - Oerd Bylykbashi
 - Genc Pollo
 - Tritan Shehu
 - Luan Baçi
 - Myslym Murrizi
 - Endri Hasa
- 4 - Çlirimi i ekonomisë nga monopolet, nga oligarkët dhe nga korrupsioni qeveritar, në funksion të mirëqenies së qytetarëve.
 - PD
 - Edmond Spaho
 - Grida Durna
 - Florian Mima
 - Jorida Tabaku
 - Albana Vokshi
 - Bardh Spahia
 - Halim Kosova
 - Orjola Pampuri
 - Agron Shehaj
 - Nadire Meçorapaj
 - Luçiano Boçi
 - Valentina Duka
 - Hekuran Hoxhalli
 - Fatbardha Kadu
 - LSI
 - Përparim Spahiu
 - Viktor Tusha
 - Edmond Panariti
 - Edmond Haxhinasto
 - Agron Çela
 - Lefter Koka
 - Shezai Rrokaj
 - Emrat e 4 koordinatorëve
 - Ervin Saliani
 - Enkeled Alibeaj
 - Jorida Tabaku
 - Luan Rama
 - Lorenç Luka
 - Izmiria Ulqinaku
 - Anton Frrokaj
 - LSI
 - Luan Rama
 - Nora Malaj
 - Floida Kërpaçi
 - Vangjel Tavo

jetë në Kuvend, por të enjten do të zhvillojë mbledhje të grupeve parlamentare në qytetin e Durrësit, me të njëjtin strategji si në Shkodër dhe Elbasan. Mbledhjet e grupeve parlamentare opozitare në disa qytete të vendi, vijnë si mesazh rezistence kundër krimi, që sipas opozitës ka mbështetjen e qeverisë. Kryedemokrati Basha përcollti te deputetët porosinë dhe me-

sazhet e shumta që ka marrë nga qytetarët, që sipas tij kërkojnë dhe duan një veting në politikë. "Shumica dërrmuese e qytetarëve përkrahen vetingun me ligj për politikanët dhe zyrtarët e lartë të lidhur me krimin e organizuar dhe të korrupsuar. Shqiptarët duan që vetingu në politikë të ndodhë. Shqiptarët kërkojnë që të mos ketë kriminelë dhe politikanë të lidhur me

krimin në Kuvend dhe qeveri. Kam marrë me mijëra mesazhe nga njerëzit që mbështesin për ta çuar deri në fund këtë proces. Kemi mbështetjen e shoqërisë. Shqiptarët kërkojnë ndarjen përfundimtare të politikës nga krimi", - mësohet të jetë shprehur z.Basha. Nisma për vetingun në politikë është një nga 4 shtyllat e platformës së përbashkët të opozitës.

SHEMBJA E TEATRIT

DEBATI

Letra: Ligji i qeverisë nuk shkel MSA, por të ftohen të gjithë aktorët e interesuar

Shembja e Teatrit, BE: Ligji të amendohet, duhet garë e hapur

"Çdo kompani private të aplikojë për projektin"

Valentina Madani

Komisioni Europian përmes një letre drejtuar qeverisë shqiptare dhe dje dakordësinë e tij për amendimin e ligjit për teatrin, por njëkohësisht kërkon nga qeveria një garë të hapur e transparente, duke ftuar edhe aktorë të tjerë të interesuar. KE flet për transparencë, teksta i rekomandon qeverisë shqiptare hapjen e garës për të tjera subjekte për të ndërtuar Teatrin e ri Kombëtar. Letra mban firmën e shefes së Njësisë për Shqipërinë dhe Bosnje-Hercegovinën në Drejtorinë e Përgjithshme për Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatave të Zgjerimit, Michela Matuella dhe i drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, Engjëll Agaçi. Zj. Matuella përmes letrës sqaron se ligji i depozituar në parlament nuk shkel Marrëveshjen e Stabilizimit-Asociimit, por i sugjeron qeverisë që të ftojë edhe aktorë të tjerë të interesuar në garë. "Komisioni Europian nuk ka asnjë kompetencë për të vlerësuar përputhshmërinë e Ligjit Special me kuadrin ligjor aktual të Shqipërisë, por në bazë të informacioneve të deritanishme nuk është e mundur të konfirmojmë apo përjashtojmë nëse ndihma shtetërore do të përfshihej në favor të kontraktorit të përzgjedhur", thekson zj. Matuella. Në letër shkruhet se, "Komisioni Europian nuk ka asnjë kompetencë për të vlerësuar përputhshmërinë e Ligjit Special me kuadrin ligjor aktual të Shqipërisë", por nga ana tjetër, ajo shprehet se nuk ka asnjë shkelje të Marrëveshjes së Stabilizimit-Asociimit. Komisioni evropian shprehet se e mbështet angazhimin e qeverisë shqiptare për të ndryshuar draftin, në mënyrë që për projektin të garantohet garë me kompanive. "Artikulli 74(3) i MSA-së i referohet dhënies së aksesit të barabartë kompanive private që duan të




Faksimile e letrës së BE-së drejtuar qeverisë shqiptare.

LETRA Shefja e Njësisë për Shqipërinë dhe Bosnje-Hercegovinën në Drejtorinë e Përgjithshme për Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatave të Zgjerimit, Michela Matuella, i dërgoi një letër qeverisë në të cilën sqarohet se ligji i miratuar në parlament nuk shkel MSA, por i sugjeron qeverisë që të ftojë edhe aktorë të tjerë të interesuar në garë.

PD: KE rrëzoi ligjin "Rama-Fusha"

Letra e KE për Teatrin, PD: Qeveria e mbajti të fshehtë 4 ditë

PD deklaroi se BE konstaton se ligji ka shkelur legjislacionin evropian për prokurimin publik, pasi shmang garën e hapur. Deputetja e PD-së, Jorida Tabaku pohoi se KE rrëzoi ligjin "Rama-Fusha" për Teatrin Kombëtar. Po ashtu në emër të PD, Tabaku theksoi se qeveria e mbajti 4 ditë të fshehtë letrën e KE-së. "Komisioni Europian ka rrëzuar zyrtarisht ligjin special 'Rama Fusha' për shkatërrimin e Teatrit Kombëtar dhe ndërtimin e kullave me paratë e drogës dhe korrupsionit, si një ligj korruptiv dhe kientelist. Qeveria e mbajti të fshehur për 4 ditë letrën e Komisionit Europian me qëllim manipulimin e opinionit publik, por përgjigja e Brukselit është e qartë: Qeveria ka sh-




kelur ligjin! Përgjigja e KE qartësisht i jep të drejtë opozitës për shqetësimet kryesore. Patëm të drejtë kur u shprehëm se ligji shkel parimin e konkurrencës. Patëm të drejtë edhe kur akuzuam qeverinë se kishte një paracaktim dhe klient preferencial, si 'Fusha shpk'. Siç edhe vëre-

het në letrën që erdhi si përgjigje e këmbënguljes së opozitës, qeveria dhe bashkia kanë shkelur me dy këmbë procedurat e prokurimit të hapur, duke mos mohuar për asnjë moment ndihmën e qeverisë për kompaninë 'Fusha', nëpërmjet dhurimit të tokës publike. Por, sikundër edhe letra artikulon qartësisht, Komisioni Europian nuk mund të jetë një institucion gjykuar për saktësinë e ligjit në fjalë në raport me Kushtetutën e vendit. Për një veprim të tillë është përgjegjëse Gjykata Kushtetuese, e cila mbahet sot e bllokuar nga mazhoranca pikërisht për të prodhuar ligje si ligji 'Fusha' dhe për të kënaqur orekset e oligarkëve apo pastruar paratë e kriminelëve dhe pushtetarëve", tha zj. Tabaku.

lidhin kontrata, duke u bazuar në Ligjin shqiptar mbi Prokurimet Publike dhe jo mbi acquis-të e Bashkimit Europian. Ndonëse në këtë pikë nuk vërejmë asnjë shkelje të MSA-së, Komisioni

Europian mirëpret vullnetin e autoriteteve shqiptare për ta amenduar Ligjin Special, me qëllim hapjen e garës për projektin e Teatrit Kombëtar, në mënyrë që çdo kompani private të mund të

aplikojë një propozim për projektin", thuhet të letrën e Komisionit Europian. Partia Demokratike deklaroi se BE konstaton se ligji ka shkelur legjislacionin evropian për prokurimin publik,



Deputeti

ERION BRAÇE

Deputeti i PS, Erion Braçe shprehet se godina e Teatrit do të ndërtohet dhe se nga letra e KE-së zbulohet se kauza e demokratëve ka qenë ankesa për të marrë pjesë në biznes. Braçe tha se BE tashmë ka vlerësuar përpjekjen për të ndërtuar një teatër të ri, ndërsa PD bërtet për fitore, pasi kërkonte të merrte pjesë në tender.

Shkresa e BE për Teatrin, Pollo: Fitore e një beteje, lufta vazhdon

Deputeti i Partisë Demokratike, Genc Pollo reagoi dje pas publikimit të letrës së Komisionit Europian për çështjen e Teatrit të ri Kombëtar. Deputeti demokrat shprehet se ligji për Teatrin shmang garën e hapur dhe "i fal 205 milionë euro kompanisë së dy Lalëve". "BE pas kërkesës sonë, konstaton se ligji 'Fusha shpk.' ka shkelur legjislacionin evropian për prokurimin publik. Ky ligj shmang garën e hapur dhe i fal 205 milionë euro kompanisë së dy Lalëve. BE detyron dy Lalët të bëjnë ligj të ri dhe të lejojnë garën. Kjo është fitore e një beteje. Falënderime Komisionit Europian. Por shkeljet e ligjit shqiptar vazhdojnë, Këshilli Bashkiak i Tiranës është anashkaluar, grabitja e pronës publike ende e mundshme, financimet e drogës presin tenderin, trashëgimia historike në rrezik. Edhe këto beteja do t'i fitojmë. Lufta vazhdon", shkruan Genc Pollo.

pasi shmang garën e hapur. Dekreti i Presidentit që ktheu për rishqyrtim ligjin e posaçëm për projektin e Teatrit Kombëtar është parashikuar që të kalojë për votim në seancën e 20 shtatorit. Përpara kësaj, ai do të diskutohet në komisionet parlamentare. Burime nga mazhoranca thanë se propozimet e Komisionit Europian do të reflektohen në draftin final.

torit. Përpara kësaj, ai do të diskutohet në komisionet parlamentare. Burime nga mazhoranca thanë se propozimet e Komisionit Europian do të reflektohen në draftin final.



Veliaj reagon pas përgjigjes së Komisionit Evropian për Teatrin

"Letra e KE lajm i shkëlqyer, mos pengoni procesin"

Për kryetarin e Bashkisë së Tiranës, institucioni që sipas qeverisë është kyç në vënien në jetë të ligjit që i hap rrugë ndërtimit të një teatri të ri me PPP në truallin ku sot gjenden dy teatro kombëtarë, letra e djeshme nga Brukseli, është një lajm i shkëlqyer.

Erion Veliaj, përmes një postimi në "Twitter" ka kërkuar që tanimë që Bashkimi Evropian ka pohuar se Marrëveshja e Stabilizim Asociimit nuk shkelet, askush të mos e pengojë procesin.

"Lajm i shkëlqyer letra e KE për Teatrin e ri! Kush kërkoj përgjigje nga BE, tani e ka dhe s'duhet ta pengojë progresin! Teksa ligji nuk shkel MSA, kemi shans ta bëjmë dhe më



të mirë akoma! Tani që pengesat ranë, le të bashkohemi dhe të ecim përpara! #TiranaNukNdalet", shkru-

an Veliaj.

Shefja e Njësisë për Shqipërinë dhe Bosnje-Hercegovinën në Drejtorinë e

Përgjithshme për Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit, Michela Matuella, i dërgoi një letër qeverisë në të cilën sqarohet se ligji i miratuar në parlament nuk shkel Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, por i sugjeron qeverisë që të ftojë edhe aktorë të tjerë të interesuar në garë. Ditën e djeshme letra ka pasur interpretime të ndryshme, ndërsa "gsh.al" ka publikuar një foto të Michela Matuella me ministrin e Kulturës, Mirela Kumbaro.

Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit: Propaganda e qeverisë, KE e fton të amendojë ligjin

"KE nuk aprovon shembjen e Teatrit"

"Letra pranon se procesi është korrriptiv"

Fatmira Nikolli

Propaganda e qeverisë po përpigjet të përhapë lajmin se Komisioni Evropian ka aprovuar prishjen e Teatrit. Kjo nuk është e vërtetë. Ka qenë ky reagimi i menjëhershëm i Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit, pasi u bë publike letra që Brukseli i drejtoi Tiranës zyrtare për çështjen e ligjit kontrovers e të debatuar, që i hap rrugë shembjes së dy teatrove kombëtarë për ndërtimin e një të ri me PPP. Prej 86 ditësh në protestë, Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit bëri me dije si fillim që vetë letra është interpretuar ndryshe nga qeveria kur tha se propaganda e qeverisë po përpigjet të përhapë lajmin se Komisioni Evropian ka aprovuar prishjen e Teatrit, çka sipas Aleancës nuk është e vërtetë.

Në vijim të reagimit për çështjen, Aleanca përmes një qëndrimi publik tha: "Komisioni Evropian 'fton qeverinë të amendojë ligjin, pasi e konsideron futjen e kompanisë në ligj si ndihmë paraprake, e cila thjesht do materializohet më vonë. Por është e qartë se sipas KE, procesi nuk është i hapur për operatorët dhe thënë në mënyrë diplomatike, pranon se ligji është korrriptiv".

Nga ana tjetër, Aleanca pranon hapur se, "ana shqetësuese e letrës është



Protestat për teatrin

ALEANCA

"Ana shqetësuese e letrës ama, është fakti që KE nuk pranon të shprehet për shkeljet e Kushtetutës".

fakti që KE nuk pranon të shprehet për shkeljet e Kushtetutës si mbivendosja ndaj pushtetit vendor dhe grabitja e pronës private. Këto probleme, KE i konsideron si jashtë kompetencës së saj". Aleanca për

Mbrojtjen e Teatrit thotë se, "megjithëse letra konfirmon faktin që procesi është korrriptiv, ajo është prova e radhës se problemet e Shqipërisë do i zgjidhin shqiptarët e jo burokratët e huaj". Për grupimin e

artistëve dhe shoqërisë civile që janë bashkuar nën strehën e Aleancës duke qëndruar për muaj të tërë në mbrojtje të dy godinave ku u themeluan institucionet e para të artit në vend, "problemet madhore të këtij 'ligji special', që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave politike dhe institucionale të pushteteve të pavarura dhe qytetarëve privat, populli shqiptar do të duhet t'i zgjidhë vetë".

Më tej, Kastriot Çipi, një prej drejtuesve të Aleancës,

DJE NË SHESH

Dje në sheshin mes dy teatrove u shfaq filmi "THE UNDAMAGED - TË PADËMTUARIT", lumenjtë e fundit të lirë të Evropës. Ai dha imazhet e një udhëtimi të egër që përfundon me një protestë emocionale përpara selisë së kryeministrit shqiptar, duke i kërkuar qeverisë që të ndalë të gjitha planet e digave në lumin Vjosa. Me rreth 500 vlotës dhe më shumë se 1,500 protestues nga 18 vende, Turi i Lumenjve të Ballkanit ishte aksioni më i madh i mbrojtjes së lumenjve në Evropë deri më sot. Vëmendja e medias ndërkombëtare ndikoi në prezantimin e çështjes së fshehtë të digave tek njerëzit në Ballkan, Evropë dhe botë duke ekspozuar koncesionet, shpesh të paligjshme për ndërtimin e hidrocentraleve.



është shprehur se, "ky ligj siç është ka rënë. Ky ligj nuk ka më asnjë vlerë. Nuk mund të parashikoj se çfarë do të ndodhë, Rama është i paparashikueshëm, nuk heq dorë nga fitimi i parave. Dyshoj se ai do të gjëjë një formulë tjetër, por nuk ka për të qenë e lehtë. Nuk ka më ligj special 'Fusha', ai ligj nuk ekziston më". Ai shton se siç duket, shqetësimi i BE-së nuk është trashëgimia kulturore. "Ne jemi kundër çdo projekti që tjetëron sado pak historinë. Do të vazhdojmë të insistojmë për një restaurim të plotë, pavarësisht se çfarë thotë BE. Jemi meuar ta shohim BE-në dhe SHBA-të si arbitër", ka deklaruar Çipi. Emra të Aleancës kanë thënë edhe me heret përmes deklaratash publike se, "çfarëdo që të ndodhë tashmë, ky ligj do të jetë përherë një njollë turpi për ata që e ideuan, nisën dhe mbështetën si akt. Vjedhja dhe abuzimi i pushtetit nëpërmjet këtij ligji janë tërësisht evidente. Precedenti që ai krijonte në shkeljen e barazisë, të drejtës së pronës, të drejtës së konkurrencës, do ishin të tmerrshme për çdo qytetar të Shqipërisë". Protesta ta teatritëve vijoi edhe mbrëmjen e djeshme, ku pjesëmarrësit i kanë qëndruar kërkueses së hershme të restaurimit të godinave dhe janë shprehur se do t'i ruajnë ato me çdo kusht.

Presidenti i Republikës, Ilir Meta vizitoi dje Institutin e Avokatit të Popullit, punonjësit e së cilët zhvilluan një seancë dhurimi gjaku, në kuadër të nismës që ka ndërmarë "Aleanca për Dhurimin e Gjaktit". Në fjalën e tij, kreu i shtetit, i shoqëruar nga zonja Erinda Ballanca, theksoi fillimisht rëndësinë e Institutit të Avokatit të Popullit, institucion që mbrohet drejtat, liritë dhe interesat e individëve, përfshirë edhe fëmijët e mitur: "Kënaqësi e veçantë që të jem sot në këtë institucion kaq të rëndësishëm të Avokatit të Popullit, i cili është një institucion kyç i demokracisë, i garantimit të të drejtave të qytetarëve, nga çdo shtet arbitrar apo cenuesë

Presidenti i Republikës, vizitë tek Avokati i Popullit

Meta: Dhuroni gjak dhe shpëtoni tri jetë, të ndërgjegjësorjëm institucionet

PRESIDENTI

"I ftoj të gjithë që të bëhen dhurues të rregullt të gjakut, sepse në këtë mënyrë jo vetëm i kontribuojnë mbarëvajtjes së shëndetit të tyre, por edhe kontribuojnë për një kauzë humane, duke ndihmuar të gjithë qytetarët tanë, të cilët e kanë nevojë jetike dhurimin e gjakut", - theksoi Presidenti Meta.

nga administrata publike apo autoritetet shtetërore. Pra, është një institucion që është dhe duhet të jetë gjithnjë pranë qytetarëve", tha Meta. "I ftoj të gjithë që të bëhen dhurues të rregullt të

gjakut, sepse në këtë mënyrë jo vetëm i kontribuojnë mbarëvajtjes së shëndetit të tyre, por edhe kontribuojnë për një kauzë humane, duke ndihmuar të gjithë qytetarët tanë, të cilët

e kanë nevojë jetike dhurimin e gjakut", - theksoi Presidenti Meta. Ndërsa Avokatja e Popullit, zonja Erinda Ballanca theksoi se, "dhurimi i gjakut është një nga ato gjëra që bëhen me dashuri të madhe, pa pasur rëndësi që të bëhet shumë e madhe". Presidenti Meta vuri në dukje gjithashtu: "Për sa i takon dhurimit të gjakut, dua të them se Shën Nënë Tereza ka një thënie të jashtëzakonshme, që u drejtohet të gjithë njerëzve kudo në botë, të cilët duan të bëjnë



vepra të mira se ndoshta secili nga ne nuk mund të bëjë dot gjëra të mëdha, por secili nga ne mund të bëjë gjëra të vogla me dashuri të madhe". "Mendoj se është edhe detyra jonë, e institucion-

eve, e autoriteteve që t'i ndërgjegjësojmë qytetarët të jenë të prirur për të ndihmuar njëri-tjetrin, pasi në këtë mënyrë ata ndihmojnë vetveten", u shpreh presidenti.

Kryediplomati grek: Problemet e së shkuarës janë tejkaluar në mënyrë efektive

Nikos Kotzias: Shumë shpejt mbyllen negociatat për 10 çështje me Shqipërinë

"Nuk kishte shanse të negocioje në regjimin e Enver Hoxhës"

Ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias ka deklaruar se shumë shpejt do të përfundojnë negociatat me Shqipërinë. Deklaratat ai i bëri gjatë fjalës së institutit norvegjez të marrëdhënieve ndërkombëtare në Oslo. "Përmes një politike të jashtme proaktive, ne jemi pranë zgjidhjes së problemeve të vjetra me Shqipërinë. Shumë shpejt besoj, ne do t'i përfundojmë negociatat për një paketë me dhjetë çështje. Kjo paketë përfshin përcaktimin e kufijve dhe zonave detare, etj.", u shpreh Kotzias. Sipas kryediplomatit grek, problemet e së kaluarës janë tejkaluar në mënyrë efektive. "Shqipëria ishte nën regjimin izolacionist të Enver Hoxhës, kështu që nuk kishte shanse për të negociuar me të. Në një masë të konsiderueshme deri në kohën e qeverisë sonë, Ballkani, Evropa Juglindore ishte një burg i paragjykimave dhe stereotipave dhe jo një vend bashkëpunimi paqësor. Bazuar në këtë parim, ne vendosëm bashkëpunimin tonë dhe të gjitha platformat e ndryshme që tani ekzistojnë me Tiranën dhe Shkupin. Unë besoj se në këtë mënyrë arritim të veprimit në mënyrë efektive me problemet e së kaluarës", theksoi ministri i Jashtëm grek. Një ditë më parë, kryeministri grek Aleksis Cipras deklaroi se Ministrinë e Jashtme po punojnë bashkërisht për negociatat, por sipas tij çështja çame nuk është në tryezën e bisedimeve. "Negociatat po zhvillohen nga dy ministrat e Jashtëm, janë çështje të vështira, por negociatat ndodhen në një nivel të mirë. Është e qartë se që të mbështesë Greqia



Ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias

ÇËSH-TJA ÇAME

"Janë dëgjuar shumë për këto negociata. Shumë nga ç'ka janë thënë nuk kanë lidhje me realitetin. Brenda kuadrit të bisedimeve është edhe mirëmbajtja e piramidave, që shënojnë kufijtë me vendin fqinj dhe disa thanë se po shkojmë të bëjmë një ripërcaktim kufijsh. Gjithashtu, disa insistojnë të fusin nga 'dritarja' çështjen çame. Nuk ekziston një çështje e tillë", u shpreh kryeministri grek, Cipras.

hapjen e kapitujve për anëtarësimin e vendit fqinj, duhet që Shqipëria të përmbyshë një sërë angazhimesh. Shumë nga këto angazhime ekzistojnë prej kohësh, që nga viti 2009. E kam fjalën për zonat detare, ndryshimin e teksteve shkollore, varrezat e ushtarëve grekë në Shqipëri. Dhe sigurisht, një çështje shumë e rëndë-

sive e reformave janë ato në lidhje me të drejtat e minoritetit grek", deklaroi një ditë më parë Cipras. Në fjalimin e tij me titull "Parimet e politikës së jashtme greke: theksi mbi stabilitetin në Europën Juglindore", ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias deklaroi se këto parime janë përqendruar te paqja dhe dialogu. Sipas tij,

interesi i Greqisë është i lidhur me rajonin e Ballkanit për shkak të ekonomisë së saj, kapitalit njerëzor dhe infrastrukturës, që janë të një rëndësie të jashtëzakonshme për zhvillimin ekonomik të të gjithë rajonit. Kotzias bëri një pasqyrë të hollësishme për 12 parimet e politikës së jashtme greke, që janë shoqëruar me 16 iniciative dhe nëntë konfigurime ndërkombëtare, të cilat janë krijuar gjatë mandatit të tij si ministër i Jashtëm. Në lidhje me Maqedoninë, Kotzias tha: "Marrëveshja e Prespës nuk është as rezultat i rrethanave dhe as zgjidhje e një presioni të jashtëm, ashtu siç është pretenduar nga opozita greke".



Nisen për në Bunavi, 144 rekrutë të rinj

Koçi: I bindur se do sakrifkoni veten për të shpëtuar qytetarët

144 rekrutë të rinj u nisën për në Shkollën e Trupës në Bunavi, Vlorë. Në ceremoninë zyrtare të nisjes së tyre në Qendrën e Personel-Rekrutimit, zëvendësiministri i Mbrojtjes, Petro Koçi u tha të rinjve se ata nuk do të jenë pjesë e zakonshme e administratës shtetërore, por do hyjnë në një nga strukturat, e cila në çdo sondazh ka dalë më e pëlqyera dhe më e dashura për publikun dhe për popullin. "Në sa e sa raste ata që më përpara jush janë bërë pjesë e FA, kanë përballuar emergjencat civile në zjarre apo në përmbytje. Edhe ju, si ata, do të bëni të njëjtën gjë. Jam i bindur që ju do të sakrifkoni nga vetja juaj për të shpëtuar qytetarët tanë, apo për të shpëtuar pronën, atë publike apo edhe atë private. Jam i bindur se shumë prej jush, ata më të mirët, do të jenë pjesë e misioneve ndërkombëtare në Afganistan, në Kosovë, në Bosnje, në Detin Egje apo edhe në misionet tjera, ku do të sjellë zhvillimi i skenës ndërkombëtare e ku do të duhet që Forcat e Armatosura të NATO të jenë prezentë për të ruajtur paqen e sigurinë, sepse ju e dini se sot rrezikët janë asimetrike", - u shpreh në fjalën përshëndetëse zëvendësiministri i Mbrojtjes. Pranë Qendrës së Personel-Rekrutimit u paraqitën 304 kandidatë, por pas testeve fizike, intelektuale dhe psikologjike, në fund u shpallën fitues vetëm 144, nga të cilët 7 kandidatë janë femra dhe 10 me arsim të lartë. Gjithashtu, në këtë ceremoni 3 ushtarakë morën gradën "oficer" dhe 3 të tjerë "nënoficer".

Komisioni i Ekonomisë rrëzon Metën për tatimin e lojërave të fatit

Ahmetaj: Nga 1 janari, asnjë kazino në qendrat e banuara

Ministri i Financave shpjegon ndryshimet në skemën e tatimit

Ornela Manjani

Nga 1 janari 2019, asnjë kazino elektronik nuk do të lejohet më të operojë në zonat e banuara. Ndërsa bastet sportive do të kenë distancë 100 metra në vijë ajrore nga njëra-tjetra. Lajmi është bërë me dije nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, i cili theksoi se nuk ka më kthim pas.

RRËZIMI I DEKRETI

Mazhoranca rrëzoi dekreten e Presidentit Ilir Meta, i cili ktheu edhe njëherë për rishqyrtim në Kuvend, Ligjin e Tatimit mbi të Ardhurat. Deputetët socialistë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë nuk pranuan pretendimet e kreut të shtetit, se ligji favorizon dhe ul barrën fiskale për kompanitë e lojërave të fatit, por përkundrazi, ata thanë se taksa rritet nga 10 në 15% për Lotarinë Kombëtare. Ministri i Financave, Arben Ahmetaj, tha se presidenti është këshilluar gabim, pasi nuk është lexuar përkufizimi i "të ardhurave bruto" në nenin 4 të Ligjit për Lojërat e Fatit, çka praktikisht nuk jep asnjë ndryshim të shumës që do të paguajmë bizneset e bixhozit. Ahmetaj premtoi se nuk do të ketë më asnjë kazino elektronike në zonat e banuara pas datës 1 janar të vitit të ardhshëm, ato do të zhvendosen në hotelet me 5 vje. Me urdhër të kryeministrit do të nisë zhvendosja edhe e pikave të basteve sportive, të cilat duhet të respektojnë distancën 100 metra larg në vijë ajrore. Dy vjet më parë mazhoranca shtyu efektet e ligjit për Lojërat e Fatit, i cili bënte zhvendosjen e kazinove jashtë qyteteve, ndërsa në secën e Komisionit të Ekonomisë, deputetët socialistë kërkuuan amendim të këtij ligji, në mënyrë që të tatimi mbi kompanitë e basteve të rritet në 50%.



Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj

ARBEN AHMETAJ

"Në 1 janar nuk do të ketë më kazino elektronike. Në bazë të ligjit, kazinotë elektronike do të largohen në zona ku me ligj do të lejohet ky aktivitet, që nuk ka lidhje me zonat e urbanizuara. E dyta, në bazë të definicionit të ligjit do të ushtrohen klauzolat e rralimit të zyrave të basteve, 1 në 200 metra".

PRESIDENTI KTHEU NË KUVEND LIGJIN

Presidenti Ilir Meta me anë të një dekreti riktheu për rivotim në Kuvend ligjin "Për tatimin mbi të ardhurat". Presidenti kërkon rishikimin e nenit 6 të këtij ligji, duke thënë në arsyetimin se ndryshimet janë të paargutueshme dhe nga vlerësimi i tyre rezultojnë se, zbatimi i këtij neni do të sjellë uljen e barrës fiskale dhe përlirimin financiar vetëm në favor të bizneseve që operojnë në fushën e lojërave të fatit.

KOMISIONI

Ministri i Financave, Ahmetaj paralajmëroi kazinotë se nga 1 janari do të largohen nga qendrat e populuara. Por, për kreun e komisionit duhet një rishikim

tjetër i ligjit, ku të parashikohet një rritje e nivelit të taksave për këto subjekte. Komisioni i Ekonomisë ka lënë në fuqi ndryshimet e bëra në ligjin për tatimin mbi fitimin e kompanive të lojërave të

fatit. Ministri Arben Ahmetaj shpjegoi se niveli i tatimit mbetet 15% dhe se i vetmi ndryshim është unifikimi i tatimit, duke përfshirë në të edhe Lotarinë Kombëtare që tatej me 10%. "Definicioni

Ndryshimet në ligjin "Për tatimin mbi të ardhurat"

Në kuadër të paketës së re fiskale, me ligjin nr.105/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar është shtuar germa g) në nenin 18 "Përjashtimet" të ligjit, ku përfshihen strukturat akomoduese "Hotel/resort me katër dhe pesë yje, status special" dhe që janë mbajtur të një marke tregtare të regjistruar nënkombëtarisht "brand name". Përjashtimi nga Tatim Fitimi për këtë kategori do të aplikohet për një periudhë 10-vjeçare dhe efektet e përjashtimit fillojnë nga momenti i fillimit të veprimtarisë ekonomike të strukturës akomoduese, por jo më vonë se 3 vjet nga marrja e statusit, me kushtin që ata ta kenë përfutur statusin special deri në dhjetor të vitit 2024. Me qëllim zhvillimin dhe stimulimin e personave juridikë që ushtrojnë aktivitete në fushën e prodhimit/zhvillimit të "software"-ve, tatimi mbi fitimin bëhet 5%, ndryshim ligjor ky i pasqyruar në pikën 2 të nenit 28 "Shkalla tatimore" të këtij ligji. Gjithashtu, në këtë ligj në nenin 38 të tij është shtuar pika 7, ku përcaktohet se "të ardhurat e organizatorëve të lojërave të fatit taten me tarifen tatimore mbi të ardhurat bruto, sipas kuptimit dhe përcaktimit në ligjet respektive të fushës".

i ligjit të 2015-ës, i importuar pa asnjë diferencë në ligjin për të ardhurat. Kjo sqaron se çfarë qëndrimi ka kjo qeveri dhe çfarë qëndrimi kanë gjithëtojt. Sa i përket dekretit, unë mendoj se ata që e kanë këshilluar presidentin, e kanë këshilluar gabim. Ajo që bën ligji, është që rrit ngarkesën fiskale për atë kompani që ishte e përjashtuar nga definicioni i standardit dhe nga taksimi prej 15%". - tha Ahmetaj. Kreu i Financave paralajmëroi të gjitha kompanitë e lojërave të fatit se

në 1 janar do të largohen nga qendrat e banuara dhe se nuk do të ketë kthim pas. "1 janari 2019, dua ta deklaroj për qytetarët sepse deputetët e dinë, nuk do të ketë shtyrje të ligjit sa i përket largimit të kazinove elektronike nga qytetet. Në 1 janar nuk do të ketë më në qytet kazino elektronike, do të largohen nga qytetet dhe këtë vendim ka marrë kjo mazhoranca e PS, qeveria e PS. Në 1 janar dua ta ndaj me kompanitë, dua ta ndaj edhe me ju, nuk do të ketë më kazino elektronike. Në bazë të ligjit, kazinotë elektronike do të largohen në zona, ku me ligj do të lejohet ky aktivitet që nuk ka lidhje me zonat e urbanizuara. E dyta, në bazë të definicionit të ligjit do të ushtrohen klauzolat e rralimit të zyrave të basteve, 1 në 200 metra", - deklaroi ministri. Kreu i Komisionit të Ekonomisë, Erjon Braçe shkoi më tej duke propozuar një rritje të mëtejshme të nivelit të tatimeve për lojërat e fatit. "Për të riparë normën e taksimit të tyre, unë kam një qëndrim të qartë në këtë aspekt, tatimi progresiv mbi të ardhurat nga kapitali duhet të shkojë në tuftë dhe mbi të gjitha tatimi progresiv mbi të ardhurat nga lojërat e fatit pa asnjë diskutim duhet të shkojë deri në masën 50%", - tha Braçe. Ligji për lojërat e fatit do të kalojë tashmë për miratim në parlament.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT
TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes së sistemeve të kondicionimit në dhomat e serverëve dhe arkivës së Bankës së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,388,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallit", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktëyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
 BIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes së sistemeve të kondicionimit në dhomat e serverëve dhe arkivës së Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 05 Tetor 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Grandet për mbrojtjen e pyjeve, afati i aplikimit 24 shtatori

Ajencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural bën me dije se afati i dorëzimit të projekt-propozimeve për grantet konkurruese "Masa për Zhvillimin dhe Mbrojtjen e Pyjeve", mbështetur nga Banka Botërore dhe qeveria suedeze është shtyrë deri më datë 24 shtator, 2018. "Masa për Zhvillimin dhe Mbrojtjen e Pyjeve", thirrja II, 2018 është 2.2 milionë euro, ku 70% e fondit do të shkojë në favor të aktiviteve të pyllëzimit për të

kanë dorëzuar projekt-propozimet teknike për miratim në bashkitë përkatëse dhe ende nuk kanë marrë aprovimin, kanë afat deri më datë 24 shtator 2018 për të paraqitur dosjet e tyre pranë zyrave qendrore të AZHRR-së. Fondi për grantet konkurruese "Masa për Zhvillimin dhe Mbrojtjen e Pyjeve", thirrja II, 2018 është 2.2 milionë euro, ku 70% e fondit do të shkojë në favor të aktiviteve të pyllëzimit për të

qenë në kohëzgjatje me vizionin e qeverisë për të shtuar sipërfaqe të gjelbra dhe 30% e fondit për aktivitetet si: masat parandaluese ndaj fenomeneve të erozionit, uji për bagëtinë, etj. Aplikantët që propozojnë aktivitetet pyllëzimi do të kenë më shumë mundësi të shpallin fitues, sepse shihet si një aktivitet veçanërisht i nevojshëm dhe i rendit këta aplikantë në pozitë më të favorshme.

STRATI
 Shoqëria përmbartimore "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njëfiton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

"Apartment", me Nr. 11/33-1/22 pasurisë, me sipërfaqe 73 m2 Zona Kadastrore 8603, volumi 36, faqe 92, regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë në pronësi të Shoqërisë "Evi Konstruksion" Sh.p.k. Çmimi fillestar i ankandit është 20.440 Euro.

"Apartment", me Nr. 11/33-1/23 pasurisë, me sipërfaqe 73 m2 Zona Kadastrore 8603, volumi 36, faqe 93, regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë në pronësi të Shoqërisë "Evi Konstruksion" Sh.p.k. Çmimi fillestar i ankandit është 20.440 Euro.

"Njësji", me Nr. 11/33-1/11 pasurisë, me sipërfaqe 26 m2 Zona Kadastrore 8603, volumi 36, faqe 63, regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë në pronësi të Shoqërisë "Evi Konstruksion" Sh.p.k. Çmimi fillestar i ankandit është 14.500 Euro. Ankandit për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 13.09.2018. Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përmbartimore "Strati Bailiffs Service", Rruga "Jordan Mirja", Pall. 1411, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Jot: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

"Nuk justifikon mijëra metra tokë buzë detit, kontratat fiktive dhe apartament me kredi"

Vetingu, shkarkohet nga detyra prokurori Bujar Hoti

KPK: Ka bërë deklaram të pasaktë

Vetingu skualifikoi ditën e djeshme nga radhët e sistemit të drejtësisë, prokurorin e Apelit të Durrësit, njëkohësisht kandidat për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Bujar Hoti. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendosi të shkarkojë nga detyra subjektin e rivlerësimit, për shkak se nuk justifikonte pasurinë. Ndonëse në raportin e ILDKPI thuhej se Hoti kishte bërë deklaram të saktë të pasurisë dhe kishte burime të mjaftueshme financiare për ta justifikuar atë, shkalla e parë e vetingut doli në të tjera përfundime. Trupa gjyqësore e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit e përbërë nga Lulzim Hamitaj, Brunilda Bekteshi dhe Olsi Komici shqyrtoi dosjen e Hotit. Sipas KPK-së prokurori nuk ka justifikuar dot mijëra metra tokë buzë detit, kontratat fiktive, apartamentet me kredi dhe udhëtimet e bashkëshortes. Konkretisht në raport thuhej prokurori nuk ka justifikuar dot mijëra metra tokë buzë detit, kontratat fiktive, apartamentet me kredi dhe udhëtimet e bashkëshortes. Gjatë seancës dëgjimore vetë prokurori Hoti irrezoi pretendimet e KPK-së, teksa deklaroi se ai dhe bashkëshortja zotërojnë të ardhura të ligjshme dhe se çdo qindarkë e kanë deklaruar konform ligjit. "Kam 32 vite që punoj si hetues. Askush s'ka kurajo të më kërkojë anën morale dhe ekonomike. Kam standard dhe jam përpilur me grupe kriminale të ndryshme. Kam mbuluar mbi 60% të Shqipërisë, dhe për këto jam shpërblyer. Moto kam vetëm punën, e s'kam asnjë vërejtje apo ankesë", u shpreh prokurori. Sa i përket aftësisë profesionale, KPK sqaroi se sipas raportit të DSJK (Drejtoria e Informacionit të Klasifikuar), prokurori Bujar Hoti është i përshtatshëm për të vazhduar detyrën e tij si prokuror. KPK deklaroi se sipas raportit të dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme, prokurori Hoti, ka aftësi për të kryer procedura hetimore, njeh ligjin dhe është i vlerësuar shumë mirë. Shkarkimi i Bujar Hotit, duket se e bën të pamundur edhe për disa kohë krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, një prej institucioneve më të



Prokurori Bujar Hoti

VENDIMI

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendosi të shkarkojë nga detyra subjektin e rivlerësimit, për shkak se nuk justifikonte pasurinë. Ndonëse në raportin e ILDKPI thuhej se Hoti kishte bërë deklaram të saktë të pasurisë dhe kishte burime të mjaftueshme financiare për ta justifikuar atë, shkalla e parë e vetingut doli në të tjera përfundime.

rëndësishme të reformës në drejtësi. Më herët janë shkarkuar nga detyra edhe kandidatët e tjerë për këtë institucion, si Besa Nikëhasani apo Luan Kaloci.

PASURIA

Sipas KPK-së prokurori Hoti, ka në pronësi një apartament banimi 157 m², dhe shtesë 30 m², në qytetin e Durrësit, me

vlerë 4 milionë e 400 mijë lekë, i blerë me kredi. Një automjet tip Audi A4, blerë për 6500 euro. Një tokë arë 4 mijë m² në Spital në Durrës, fituar nga ligji 7501, dhe një zyrë noteriale me sipërfaqe 41.3 m² dhe një shtesë prej 19.6 metra katrorë. Bashkëshortja e Hotit ka pasur të ardhura si notere nga

viti 2003 deri në vitin 2016, në rreth 43 milionë lekë. Prokurori Hoti nga viti 2003 deri në vitin 2016 ka pasur të deklaruara të ardhura në shifrën e 22 milionë lekëve. KPK deklaroi se për njërin nga fëmijët e Hotit është paguar një tarifë për shkollimin në Universitetin e Oxfordit, në Angli.

KPA lë në fuqi pushimin e vetingut,

Mirela Fana 15 vite larg sistemit të drejtësisë

Kolegi i Posaçëm i Apelitit shqyrtoi ditën e djeshme ankimin e Komisionerit Publik për ish-gjykatësen e lartë Mirela Fana. Komisioneri ishte kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që pushoi procesin e rivlerësimit për Fanën, për shkak të dorëheqjes. Sipas tij, Fana duhet të kalonte në filtrin e trefishtë të vetingut, me argumentin se gëzonte statusin e magistrates, ndonëse ishte larguar nga detyra e gjykatëses supreme. Gjatë seancës, gjyqtarja ka vendosur të mos jetë e pranishme në seancë dhe as të mos përfaqësohet nga një avokat. Trupa gjyqësore përbëhej nga Natasha Mulaj, relatorja Rezarta Schuetz dhe anëtarë: Albana Shtylla, Ardian Hajdari dhe Sokol Çomo. KPA vendosi të lërë në fuqi pushimin e vetingut duke lënë, gjyqtaren Fana larg sistemit të drejtësisë për 15 vite. Përgjatë kësaj kohe, ish-gjykatësja e Lartë nuk mundet të kandidojë për organet e reja të drejtësisë që krijohen në kuadër të reformës në drejtësi. Fana dha dorëheqjen nga posti në Gjykatën e Lartë në janar të vitit të shkuar, pak përpara nisjes së procesit të Vetingut, me një akt shkresor pranë presidentit. Arsyet e dorëheqjes sipas saj ka qënë thëllimi i studimeve akademike. Por edhe pas dorëheqjes, Fana ka gëzuar statusin e magistratit. KPK vendosi më herët të pranojë dorëheqjen e Fanës dhe për rrjedhojë ndërpreu vetingun ndaj saj, por Komisioneri Publik, Florjan Ballhysa, e ankimoi vendimin në KPA.



"Dëshmitarët panë ngjarjen si ndodhi"

Kërcënoi me jetë gjyqtarin? Vëllai i të arrestuarit: S'është e vërtetë

KORÇË - Pas shoqërimit të shtetasve Emin Myrtollari dhe Muhamet Hoxha në polici, me akuzën për kërcënim të gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë në Korçë Besnik Shehu, vëllai i Emin Myrtollarit, Baki Myrtollari thotë se gjyqtari Besnik Shehu ka sjuar gjithçka dhe se kërcënimin nga Emmini nuk ka ndodhur. Sipas versionit të vëllait, Emmini ka qënë në vendin e tij të punës duke shitur fruta perime në tregun e Korçës kur gjyqtari Shehu ka kaluar pranë tij dhe e ka provokuar me fjalë.



Pas denoncimit të gjyqtarit, Emin Myrtollari ka dhënë sqarimet në polici

dhe do të procedohet në gjendje të lirë. Vëllai i tij se bashku me përfaqësues-

PETRO KOCI

Pas denoncimit të gjyqtarit, Emin Myrtollari ka dhënë sqarimet në polici dhe do të procedohet në gjendje të lirë. Vëllai i tij së bashku me përfaqësuesin ligjor të familjes thonë se shumë shpejt do ta padisin gjyqtarin Besnik Shehu.

in ligjor të familjes thonë se shumë shpejt do ta padisin gjyqtarin Besnik Shehu. Myrtollarët janë në gjyq për pronat në fshatin Porodinë me shtetasin A. Qeraxhiu. Gjyqtari Shehu në vitin 2016 ka dhënë një vendim në disfavor të vëllezërve Myrtollari, vendim i cili u apeluar, por edhe Apeli lanë fuqi vendimin e Shkallës së Parë. Tashmë çështja ndërmyjet palëve ndërëgjygjësë për pronat është në Gjykatën e Lartë.

KRUJË - Një shpërthim i fuqishëm me tritol ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të djeshëm në qytetin e Krujës duke shkaktuar panik tek banorët. Sipas burimeve nga policia, rreth orës 02:45, persona ende të paidentifikuar kanë vendosur eksploziv në banesën e drejtorit të OSHEE-së. Fatmirësisht nga shpërthimi nuk ka të dëmtuar, por vetëm dëme materiale.



Tronditet Kruja, shpërthim me tritol në banesën e drejtorit të OSHEE-së

Mësohet se është dëmtuar automjeti i kryefamiljarit Xhavit Masha që ndodhej i parkuar në oborr. Po kështu, nga shpërthimi janë dëmtuar dyer e dritare, ndërsa janë plasaritur muret si dhe ka lëvizur çatia e shtëpisë. Pas shpërthimit të zotët e banesës

kanë njoftuar policinë, e cila ka mbërritur menjëherë në vendngjarje dhe ka filluar hetimet për këtë akt të rëndë kriminal. Familja Masha njihet në zonë si familje e respektuar dhe nuk kanë probleme apo konflikte me njeri. Ndaj dysho-

het se ngjarja ka lidhje me detyrën e djalit të Xhavitit, i cili është drejtor i OSHEE për rrethin e Krujës. Policia dhe prokuroria e Krujës janë duke hetuar intensivisht për identifikimin dhe vënien në pranga të autorit/ve.

Shkatërrohen dy banda kriminale. Lënda narkotike kapte vlerën 20 mln euro

Operacion antidrogë në tri shtete, bien në pranga 18 shqiptarë

Trafikuan 120 kilogram drogë mes së cilës kokainë

Një operacion masiv antidrogë i zhvilluar në tre shtete, Itali, Gjermani dhe në Shqipëri ka përfunduar me arrestimin e 20 personave, mes të cilëve 18 janë shqiptarë, një shtetas kosovar dhe një pakistanez. Personat e arrestuar janë anëtarë të dy bandave të ndryshme, dhe akuzohen për trafik ndërkombëtar droge. Gjatë operacionit kundër trafikut të drogës nga Europa e veriut drejt Italisë u sekuestrua 120 kilogram drogë mes së cilës kokainë, heroinë dhe marijuanë. Droga e sekuestruar kap vlerën mbi 20 milion euro.

Konkretisht anëtarët e bandave ranë në pranga: 16 në Itali, 3 në Gjermani dhe një në Tiranë. Operacioni i quajtur "Alba Bianca" u krye në Trentino-Alto Adige, Lombardi dhe Veneto. Trafikantët që kanë përfunduar në pranga bënin pjesë në dy grupet "Baruti" dhe "Bushi".

Sipas hetuesve, grupi "Baruti" përbëhej nga 13 anëtarë: Florjan Musaj, Eduart Gona, Artur Muca, Eljon Baruti, Keti Shani, Klevin Kodra, Artan Sokola, Shafique Mohammad Amar, Rajmond Prenga, Ben Jale Aziza Omar, Erion Alla, Halil Alla. Grupi "Bushi" përbëhej nga 7 anëtarë: Vaskë Xherahu, Hamit Bushi, Arben Lleshi, Odeon Proko, Blerina Cela, Manfred Hophensberger, Qerim Lumi. Ata merreshin me trafik heroinë, kokainë dhe marijuanë. Banda kishte degë edhe në Holandë, Belgjikë dhe në Austri, ndërsa bazën e kishin në veri të Italisë. Ende nuk dihet kush është shqiptari i ndaluar në Tiranë, si pjesë e këtyre grupeve kriminale. Operacioni u fillua që në vitin 2016 dhe u finalizua ditën e djeshme nga Guardia di Finanza e Trentos. Hetimet filluan pas sekuestrimit të 91 kg kokainë në kufirin Itali - Austri në 2016. Dy grupet shqiptare që u goditën Baruti dhe Bushi, pasi merrnin kokainën nga Belgjika, ndërsa heroinën nga Holanda e trafikonin në pas nga Gjermania në Itali, ku kishin bazën dhe më pas në vendet e tjera të Europës. Në vendin fqinj ata bashkëpunonin edhe me mafien



SEKUESTRIMET

- 94 kg e 950 gramë kokainë
- 2.1 kg heroinë
- 21.3 kg kanabis
- 100 mijë euro
- 5 makina
- 3 motorë

ARRESTIMET

GRUPI BARUTI:

- Florjan Musaj
- Eduart Gona
- Artur Muca
- Eljon Baruti
- Keti Shani
- Klevin Kodra
- Artan Sokola
- Shafique Mohammad Amar
- Rajmond Prenga
- Ben Jale AZIZA Omar
- Erion Alla
- Halil Alla

GRUPI BUSHI:

- Vaskë Xherahu
- Hamit Bushi
- Arben Lleshi
- Odeon Proko
- Blerina Cela
- Manfred Hophensberger
- Qerim Lumi

20 MILIONË EURO

Personat e arrestuar janë anëtarë të dy bandave të ndryshme, dhe akuzohen për trafik ndërkombëtar droge. Gjatë operacionit kundër trafikut të drogës nga Europa e veriut drejt Italisë u sekuestrua 120 kilogram drogë mes të cilës kokainë, heroinë dhe marijuanë. Droga e sekuestruar kap vlerën mbi 20 milionë euro.

Monitorimi me dron, Policia Rrugore penalizon 137 shoferë

TIRANË - Vijon aksioni i nisur nga policia rrugore për të gjithë shoferët që shkelin rregullat e qarkullimit, duke i monitoruar me dron. Gjatë monitorimit u kapën shumë raste flagrante. Policia bën me dije se gjatë javës që kaloi janë evidencuar me dron 67 parakalime të gabuara, ndërsa 30 për shpejtësi tej normave të lejuara. "Njësia Operacionale e Policisë Rrugore në bashkëpunim me rrugorët vendorë vijon monitorimin e qarkullimit rrugor në të gjitha asket rrugore të vendit, për të evidencuar parakalimet e gabuara dhe manovrat e rrezikshme në rrugë të cilat janë burim aksidenti. Kontrollat janë përqendruar edhe në drejtim të shpejtësisë duke përdorur radarin. Gjatë javës që kaloi janë evidencuar me dron 67 parakalime të gabuara; 30 për shpejtësi tej normave të lejuara ku janë dërguar në OASH për pezullim të Lejes së Drejtimit; 28 për mosvendosje të rripit të sigurimit; 12 për shkelje të ndryshme si mungesë siguracioni, kontrolli teknik etj. Policia Rrugore në të gjithë vendin është e angazhuar për të parandaluar, evidencuar dhe ndëshkuar çdo shkelje të qarkullimit me qëllimin e vetëm rritjen e parame-trave të sigurisë së jetës në rrugë. Zbatim i rregullave të qarkullimit rrugor: destinacion i sigurt. Javë të mbarë!", thuhet në njoftimin e Policisë së Shtetit.

italiane. Për sa i përket kanabisit, trafikohej nga Shqipëria drejt Italisë e më pas në Gjermani. Sipas mediave italiane, banda kishte makina të modifikuara posaçërisht për të transportuar kokainë, kanabis dhe heroinë për në Italinë Veriore dhe në Gjermani. Banda

llogaritet që ka trafikuar në total 120 kg drogë, marijuanë, kokainë e heroinë në vlerë mbi 20 milionë euro. Ndërkohë që janë sekuestruar 8 automjete të përdorura për trafikun e drogës, mbi 100 mijë euro cash, ndërsa mbi 40 korrierë janë arrestuar nga 2016.

SHKURT

Vetëvritet me pistoletë në stan 13-vjeçari

VLORE - Një 13-vjeçar ka humbur jetën tragjikisht në fshatin Fitore të Vlorës. Trupi i pajetë i minoritetit është gjetur nga babai i tij në një stan. Menjëherë i ati ka lajmëruar policinë, e cila ka shkuar në vendin e ngjarjes dhe ka nisur hetimet. Trupi i 13-vjeçarit është dërguar në morgun e spitalit të Vlorës ku i është nënshtruar ekspertizës. Burime zyrtare nga blutë e qytetit bregdetar bënë me dije se dyshohet për vetëvrasje. "Më datë 10.09.2018, rreth orës 16:40, në fshatin Fitore, Vlorë, dyshohet se është vetëvrasur aksidentalisht me armë zjarri një djalë i mitur me gjeneralitetet M.A., 13 vjeç. Në momentin e ngjarjes, fëmija ka qenë vetëm duke luajtur në një godinë ngjitur me banesën, ku dyshohet se është vetëvrasur aksidentalisht me armë zjarri tip pistoletë "TT". Grupi hetimor po punon për sqarimin e rrethanave dhe dokumentimin e plotë të ngjarjes", deklaroi policia e Vlorës.

Drogë në "Range Rover", bien në pranga 3 të rinj

VLORE - Tre të rinj nga Vlora kanë përfunduar në pranga, pasi iu është gjetur një sasi kanabis në makinën tip "Range Rover", me të cilin po udhëtonin. Lënda narkotike është gjetur e fshehur në makinën me targa AA 023 KR, gjatë një kontrolli të ushtruar dy ditë më parë nga blutë e qytetit bregdetar në kuadër të operacionit të koduar "JAD 2018". Sakaq, janë arrestuar shtetasit: Bezhani Dervishaj, 25 vjeç, dhe Blerim Dervishaj, 24 vjeç, të dy banues në fshatin Poçëm, Mallakastër; dhe shtetasi Laim Lelaj, 26 vjeç, banues në fshatin Gorisht, Vlorë. Materialet në ngarkim të personave në fjalë iu referuan prokurorisë për veprat penale: "Prodhim dhe shitja e narkotikëve" kryer në bashkëpunim dhe "Moskallëzimi i krimtit".

Tentoi të fuste celular në burg, kapet gardiani

KRUJË - Një polic në burgun e Fushë-Krujës është arrestuar, pasi tentoi të fusë në ambientet e burgut një celular. Bib Prend Beqiri u prangos nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në sistemin e Burgjeve. Gjatë kontrollit të ushtruar para marrjes së shërbimit 56-vjeçarit i është konstatuar se mbante të fshehur një send të dyshimtë në pjesën e poshtme të këpucës së djathtë që rezultoi të ishte një aparat telefoni Iphone 5, ngjyrë e zezë, pa kartë SIM. Gjatë akuzohet për "Futje ose mbajtje se sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim" dhe "Shpërdorimi i detyrës".



Programi 'Yes', mundësi shkollimi falas për një vit

Mundësi studimi në Shtetet e Bashkuara

Ambasada: Kriteret që duhet të plotësoni

Voltiza Duro

Të gjithë nxënësit e klasave të 10-ta ose të 11-ta, që duan të ndjekin studimet në Amerikë, tashmë mund të mësojnë më shumë mbi programin që e ofron këtë mundësi. Ditën e djeshme ambasada amerikane në Tiranë, nëpërmjet një njoftimi bën me dije se programi 'Yes', i financuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit, u ofron nxënësit të shkollave të mesme në Shqipëri mundësinë për të jetuar me një familje amerikane dhe për të studiuar aty pa pagesë. "Jeni në klasën e 10-të ose të 11-të në shkollë të mesme? Keni rezultate të mira në shkollë? Jeni lindur nga 1 janari 2002 deri më 15 korrik 2004? Programi 'Yes', financuar nga Departamen-

KUSHTET

Ju mund të aplikoni nëse jeni:

- ◆ Në vitin e 10-të ose të 11-të të shkollës së mesme.
- ◆ Keni një qëndrim "të mirë" akademik në shkollë.
- ◆ Keni lindur ndërmjet 1 janarit 2002 dhe 15 korrikut 2004.
- ◆ Nxënësit me aftësi të kufizuara të çfarëdo grade mund të aplikojnë nëse kanë lindur ndërmjet 15 shkurtit 2001 dhe 15 korrikut 2004.

ti Amerikan i Shtetit, u ofron nxënësit të shkollave të mesme në Shqipëri mundësinë për të jetuar me një familje amerikane dhe për të studiuar në një shkollë të mesme në Shtetet e Bashkuara për një vit pa pagesë! - thuhet në njoftim. Programi 'Yes' është hartuar për nxënësit e shkollave të mesme në Shqipëri, në mënyrë që ata të ndjekin një vit studime në SHBA falas. 'Yes' është financuar plotë-

sisht nga Departamenti i Shtetit i SHBA dhe zbatohet nga Këshillat Amerikanë. "Ju mund të aplikoni nëse jeni: në vitin e 10-të ose të 11-të të shkollës së mesme, keni një qëndrim "të mirë" akademik në shkollë, keni lindur ndërmjet 1 janarit 2002 dhe 15 korrikut 2004 (nxënësit me aftësi të kufizuara të çfarëdo grade mund të aplikojnë nëse kanë lindur ndërmjet 15 shkurtit 2001 dhe 15 korrikut 2004).

Manastirliu: Të garantojmë mbarëvajtjen e vitit shkollor


Inspektim në 1094 shkolla në vend për kushtet higjieno - sanitare

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor ka nisur kontrollin masiv në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në të gjithë vendin për plotësimin e kushteve higjieno-sanitare. Gjatë inspeksioneve në shkollën 9-vjeçare "Dine Ismaili" dhe shkollën e mesme "Janaq Kilica", ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, tha se deri më tani janë kryer 1094 inspeksione me terren. "Për t'i paraparirë fillimit të vitit të ri shkollor, nga Inspektorati Shtetëror



Shëndetësor janë kryer 1094 inspeksione, 119 prej të cilave vetëm në Fier, në institucione arsimore publike dhe jo publike parashkollë dhe shkollë, për plotësimin e kushteve higjieno-sanitare

në mënyrë që të garantohet mbarëvajtja e duhur e vitit të ri shkollor që nis pas pak ditësh", tha Manastirliu. Ndërkohë, ministria shtoi më tej se do të bëhet po ashtu riverifikimi në të gjitha institucionet arsimore, nëse i kanë plotësuar detyrat e caktuara nga inspektorati, në mënyrë që shkollat të jenë gati me standardet e duhura për fillimin e vitit të ri shkollor 2018-2019. E pranishme gjatë inspeksioneve në shkollat e Fierit ishte edhe ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Lindita Nikolla.



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GIZ GmbH

Field of Activity

The *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit* (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development.

Open Regional Fund Modernisation of municipal services (ORF MMS)
The Open Regional Funds for South-East Europe have been established on behalf of the German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ) with the aim to build capacities and to support EU integration of the South-East European countries through regional projects
These countries are facing great challenges due to decentralization, especially in the field of municipal services. Municipalities and public utilities often lack capacities and products necessary for implementing the EU's demanding standards, which require to improve the quality of municipal services. In order to meet these challenges, the Open Regional Fund for South-East Europe – Modernisation of Municipal Services (ORF MMS) strengthens the capacities of regional networks such as the Network of Associations of Local Authorities in South-East Europe (NALAS) to achieve cooperation between the members within the network as well as with other networks in order to effectively provide the users of municipal services with high quality and efficient service
The Open Regional Fund for South-East Europe – Modernisation of Municipal Services has established itself as a relevant cooperation and networking platform for all regional stakeholders interested in improving municipal services in South-East Europe.

Open Regional Funds for South-East Europe – Implementation of the Convention on Biological Diversity (ORF BDU) in the Western Balkans
The Western Balkans region (Albania, Bosnia and Herzegovina, Kosovo, Macedonia, Monte-negro and Serbia) is exceptionally rich in terms of biodiversity and harbours a large variety of ecosystems that range from Mediterranean coastal areas, over rivers, forests and steppes to high alpine mountain regions. The Western Balkans therefore plays a crucial role in the conservation of biodiversity in Europe. Western Balkans countries have committed themselves to biodiversity conservation in the framework of international agreements on biodiversity conservation, most of them signed and ratified, in particular the 2030 Agenda, the UN Biodiversity Convention (CBD), the Bern Convention on the Conservation of Wildlife and Natural Habitats, the Convention on International Trade in Endangered Species of Wild Fauna and Flora (CITES), the International Convention on the Protection of the Cultural and Natural Heritage of the World drawn up by UNESCO, the Convention on Wetlands of International Importance especially as Waterfowl Habitat (the Ramsar Convention) and the UN Framework Convention on Climate Change.

The goal of the TC module is strengthening the regional cooperation between the countries of the Western Balkans regarding the fulfillment of international obligations for the preservation of biodiversity, and EU-related obligations under the environmental *acquis communautaire* in particular.

The project aims to 1) improve the performance of functions of regional structures created by its predecessor as interest groups for advocating biodiversity conservation in the EU integration process and institutions, namely the Biodiversity Task Force established under the Regional Cooperation Council (RCC), regional scientific platform and NGO network as well as local coordination structure of a cross-border conservation area, 2) improve the regional exchange of information on biodiversity conservation between public sector, scientific and civil society actors, and 3) better incorporate the assessment of ecosystem services as an instrument of public development planning in the region in educational institutions for public administration.

GIZ Office to Albania seeks the following staff: **Office Manager**

A. Sphere of responsibility

The office manager is responsible for the:

- ensuring efficient day-to-day running of the project offices (ORF BDU and ORF MMS)
- acting as focal point for both projects on administration and finances including contracting as needed;
- providing administrative, organizational and logistical services to the project management and teams;
- managing project data and file management system in DMS in line with GIZ's filing rules;
- ensuring good flow of communication and information within the projects and with the GIZ office in Tirana.

The office manager performs the following tasks:

B. Tasks

1. Secretariat work and services
The office manager

- organizes and coordinates project activity schedules as requested by each project representative;
- prepares and organizes information materials for the ORF project representatives and – or meetings;
- manages incoming and outgoing correspondence and prioritizes and organizes it;
- replies and looks after correspondence;
- Participates in internal and external meetings and workshops and assists with documenting these (minutes);
- ensures that the necessary office supplies are available;
- purchases office equipment and supplies within set value limits and procurement rules;
- reports damage to the project officer, organizes and monitors the service and repair of office equipment.

2. Office coordination, office management and coordination
The office manager

- deals with external contacts;
- coordinates and organizes rooms for meetings and catering;
- coordinates travel arrangements of team, partner and experts as needed;
- coordinates equipment for meetings;
- photocopies and scans documents as needed;
- supports the preparation and submission of VAT reimbursement documents to respective Ministries;
- in charge of office inventory including regular update of list;
- responds on requests from ORF management team in Sarajevo;
- interprets and translates as needed and possible upon request.

3. Other duties/additional tasks
The office manager

- performs other duties and tasks at the request of management and ORF representatives

C. Qualifications, skills and experience required

Qualifications:

- university degree in relevant qualification: Finance and/or Business; Management/Administration equivalent of BA or MSc;
- at least 3 years professional experience in a similar position;
- experience in office and programme management, particularly within international organizations;
- ability to support a multi-task, multi-discipline international programme team;
- excellent working knowledge of MS products, particularly Word, Excel and PowerPoint;
- fluency in written and spoken Albanian and English, German language would be an asset;
- able to work in a team as well as independently;
- excellent social and communications skills.

Contract conditions:

- Full time employment, 50% ORF MMS and 50% ORF BDU;
- Programme office in Tirana with few travels in the region;
- Assignment period: one year

Please forward your application until **19th of September 2018**, to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de, including the following information: Application letter, CV in English (Euro Pass format), references. Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates will be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.
GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!

"Nuk marrim faktorët në masën që jepet në recetë. Zëri ynë ka rënë në vesh të shurdhët"

Voltiza Duro

Pas denoncimit të mu ngesës së faktorëve për rreth 300 persona që vuajnë nga hemofilia, vetë pacientët zbardhin realisht problematikat që hasin çdo ditë. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", 22-vjeçari me hemofili, Besart Nezaj tregon se medikamenti që ai merr për t'u trajtuar vjen në sasi të pakët. Si pasojë, 22-vjeçari i shfaqen hematoma e ka dhimbje të artikulacioneve, e nëse nuk merr trajtimin në kohë, gjendja e tij shëndetësore vazhdon të përkeqësohet. Nezaj thekson më tej se pavarësisht faktit që në recetë mjekët referojnë një sasi të caktuar, kur paraqitet pranë farmacisë merr sasi më të vogël të medikamentit, pasi sipas farmacistëve, nuk ka faktor të mjaftueshëm. Pavarësisht thirrjeve të tyre e letrave drejtuar instancave përgjegjëse, deri më tani nuk ka një zgjidhje konkrete për situatën.

Sa vjeç jeni dhe prej sa vitesh vuani nga hemofilia?

Unë jam 22 vjeç dhe mosha që jam diagnostikuar me hemofili ka qenë

Flet 22-vjeçari me hemofili: Ka mungesë në sasi të ilaçeve që marrim

Besart Nezaj: Gjendja jonë shëndetësore po përkeqësohet



Besart Nezaj, pacient me hemofili

PASOJAT

"Që hemofilikët të bëjnë një jetë normale, duhet të marrin faktorin rregullisht dhe në sasinë e duhur. Kjo do i shmangte invaliditetin dhe do bënim një jetë cilësore. Profilaksia, pra parandalimi i sëmundjes nuk ofrohet në Shqipëri", - shprehet 22-vjeçari.

"HEMOFILIA, SFIDË PËR NE"

"Hemofilia është një sfidë për ata që jetojnë në Shqipëri. Të pengon në jetën sociale, të bën invalid, nuk integrohesh, ke probleme me frekuentimin në shkollë. Them sfidë, pasi dhe ata që marrin forcë për të filluar një gjimnaz, përballen me 1001 vështirësi", - thotë i ri.

1 vjeç. Edhe vëllai im vuan nga e njëjta sëmundje.

Në cilin stad të sëmundjes jeni aktualisht dhe me çfarë medikamenti po trajtoheni?

Unë kam lindur me formë të rënde hemofilie dhe ky është një stad që nuk ndryshon gjatë gjithë jetës. Kohët e fundit jam diagnostikuar dhe me Inhibitor, çka e përkeqëson gjendjen time si hemofilik dhe për momentin përdor medikamentin Faktor 7 NovoSeven 2 Mg.

A keni pasur mungesa të faktorit me të cilin po mjekoheni? Nëse po, prej sa kohësh?

Edhe në bisedimet që kam pasur me pacientët të tjerë, mungesa e faktorëve 9,8,7 ka plot 28 vjet, sepse medikamenti vjen në sasi të pakët, por ka pasur raste që në 2015. Në datën 2 gusht 2015 jam mjekuar me tranfuzion jaku. Që hemofilikët të bëjnë një jetë normale, duhet të marrin faktorin rregullisht dhe në sasinë e duhur, kjo do i shmangte invaliditetin dhe do bënim një jetë cilësore. Profilaksia, pra parandalimi i sëmundjes nuk ofrohet në Shqipëri. Sipas Federatës Botërore së Hemofilisë, në një studim të bërë, Shqipëria ka 0% profilaksi. Sasia e pakët e faktorit shkakton Inhibitorin, pasi pacienti me hemofili duhet të marrë sasinë e duhur në raport me peshën, gjatësinë etj.

A i keni marrë gjithmonë faktorët në sasinë e duhur sipas recetës së mjekut?



Deputetja e PD: Rrezikohen rreth 300 pacientë me hemofili

Sipas denoncimit të dy ditëve më parë, rreth 300 pacientë me hemofili vuajnë nga mungesa e medikamentit bazë për mpiksjen e gjakut, duke rrezikuar jetën e tyre. Në një dalje për mediat, deputetja e Partisë Demokratike, Orjola Pampuri denoncoi mungesën e faktorit 7, 8 dhe 9. Sipas Pampurit, ky medikament kushton nga 120 mijë lekë deri në 200 mijë lekë, shifër kjo e papërbalueshme nga pacientët. Sipas opozitës, Ministria e Shëndetësisë nuk shpjegon pse QSUT nuk bën faktorë të mjaftueshëm për trajtimin normal të të sëmurëve. "Në këtë situatë ku luhet me jetën e të paktën 300 të sëmurëve me hemofili, Ministria e Shëndetësisë hesht dhe nuk shpjegon pse QSUT nuk bën faktorë të mjaftueshëm për trajtimin normal të të sëmurëve", deklaroi deputetja e PD.



QSUT: Pacientët me hemofili trajtohen rregullisht

Pas akuzave të deputetes së Partisë Demokratike, Orjola Pampuri, Drejtorja e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" sqaroi opinionin publik nëpërmjet një deklarate të publikuar në media lidhur me mungesën e medikamentit "faktor" 7, 8 dhe 9, të cilët shërbejnë për mpiksjen e gjakut tek të sëmurët me hemofili. QSUT tha se nuk ka asnjë të vërtetë lidhur me këto mungesa. "Faktori 7, 8 dhe 9 është shpërndarë dhe vazhdon të shpërndahet për pacientët që kanë nevojë për të, sipas përshkrimeve në recetë të mjekëve hematologë në QSUT. Këto deklarata të pavërteta përveçse dezinformojnë opinionin publik, hedhin balte edhe mbi punën tonë të përditshme në shërbim të pacientëve", - theu në deklaratën e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza".

gjë konkrete.

Çfarë ju ndodh në momentin që nuk merrni medikamentin?

Nëse faktori nuk merret në sasinë e duhur shfaqen hematoma dhe spontane, ke dhimbje të artikulacioneve dhe 85% janë të invalidizuar pjesërisht apo plotësisht.

Sa ju pengon hemofilia në jetën tuaj të përditshme?

Hemofilia është një sfidë për ata që jetojnë në Shqipëri. Të pengon në jetën sociale, të bën invalid, nuk integrohesh, ke probleme me frekuentimin në shkollë. Them sfidë, pasi dhe ata që marrin forcë për të filluar një gjimnaz përballen me 1001 vështirësi.



INVITATION TO TENDER

REHABILITATION OF THE TWO PRIMARY HEALTH CENTRES IN VORA AND SAUK

The Health for All Project (HAP) in Albania is funded by Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) of the Swiss Government and is being implemented by a consortium of three organizations: the Swiss Tropical and Public Health Institute (SwissTPH), and the two NGOs: Terre des hommes (Tdh) and Save the Children (SC) through HAP Centre. Its overall goal is that the Albanian population, benefit from better health due to improved primary health care services and health promotion activities.

HAP will rehabilitate two primary health care centers: one health center in Vora, in the municipality of Vora and the second health center in Sauk, in the municipality of Tirana. In the context of this initiative, HAP Centre is requesting offers from companies interested to carry out those rehabilitation works.

The required documents, forms, technical specifications and annexes for the bidding can be found in the HAP web site link: <http://www.hap.org.al/opportunities-for-cooperation-2/>

The interested Companies should express their interest in participating in this tender by sending an email to info@hap.org.al until 14th of September 2018.

The interested Companies **must participate** in the site visit to take place within **third week of September 2018**. The details of place and time of the visit will be given to the interested Companies within 17th of September 2018.

The bidding Companies should submit their offers to HAP Centre no later than end of business day on the 5th of October 2018.

The offer should include:

- Letter of interest (see Appendix 4.2);
- The BoQ Excel sheet provided with the tender documents, filled with the respective prices and totals (BoQ template provided in Appendix 2.1);
- The financial offer in correspondence with the subtotals and total amounts in the BoQ (Format provided in Appendix 2.0);
- CV of the company (with proves of the experience of the company in carrying out similar works);
- CVs of directors of the Company;
- CV of technical team directly responsible for the coordination of the works and to will be deployed to do the work sites (see Appendix 4.2 and Appendix 4.3);
- The time table of the works with a brief narrative of the timing and sequence of the jobs to be carried out (see Appendix 4, Appendix 4.1);
- Copy of the registration and license of the company;
- Copy of its status with the tax authorities and confirmation of Tax Authorities for having No obligations;
- Document from the bank as a proof of its commercial links and sound finance (within the required limit for such works, see Appendix 4.2);
- For the preparation of the offers, the companies will be obliged to visit the site, verify and make its own measurements; a short report of the visit should be added to the offer.

The application should be sent in sealed envelope no later than end of business day on the 5th of October 2018 to the address:

Subject: REHABILITATION OF THE TWO PRIMARY HEALTH CENTRES IN VORA AND SAUK
Procurement Team
HAP Centre
Rruga "Themistokil Germerij", Pallati Helios, Kati II, Ap.1, Tirana, Albania
E-mail: info@hap.org.al; Website: www.hap.org.al

Prokuroria: Kemi prova se 2 të pandehurit janë autorë të ekzekutimit të 43-vjeçarit

Vranë kushëririn me plumb në kokë për pronën, lihen në burg babë e bir

Hetem dhe Dino Muho në gjyq: Nuk e qëlluan ne fqinjin, ndodheshim rastësisht në fshat

Brikena Metaj

GJIROKASTËR

Gjykata e Shkallës së Parë e Gjirokastrës dje vendosi masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj 59-vjeçarit Hetem Muho dhe djalit 20-vjeçar të këtij të fundit, Dino Muho, të cilët akuzohen se për ekzekutimin me plumb në kokë të fqinjit dhe kushëririt të tyre, Alket Muho. Ngjarje kjo e ndodhur rreth orës 11:35 në vendin e quajtur "Bolovec" në fshatin Rabie të Memaliajt. Gjatë seancës gjyqësore që u zhvillua me dyer të mbyllura pasditen e djeshme, babë e bir nuk e pranuan krimin, ndërsa deklaruan se nuk kishin lidhje me



43-vjeçari i vranë, Alket Muho

ngjarjen e rëndë ku mbeti i vranë 43-vjeçari. "Ndodheshim rastësisht në fshatin Rabije. Ne ishim për vizitë në vendlindje. Pavarësisht konflikteve të mëparshme, me të kemi pasur raporte si me të gjithë banorët e tjerë të fshatit", kanë pohuar para togave të zeza dy të akuzuarit si autorë të vrasjes së Alket

Muhos. Babë e bir (banues në fshatin Çukë të Sarandës) teksa qëndronin pas kafazit të hekurt u shprehën se nuk e kishin vranë ata 43-vjeçarin. Mësohet se Hetem dhe Dino Muho kanë dhënë dëshmi kontradiktore gjatë marrjes në pyetje. Ndërkaq, përfaqësuesi i akuzës ka deklaruar se kanë prova se Hetem dhe Di-

no Muho janë ekzekutorët e 43-vjeçarit. Një ndër provat e forta të prokurorisë mbetet mungesa e një çifteje që 59-vjeçari Muho e kishte me leje, ndërsa kishte deklaruar se i ka humbur. Akti i ekspertimit ka konfirmuar se në trupin e viktimës ka plagë plumbi kallashnikov dhe çifteje. Nga tërësia e veprimeve dyshohet se dy autorët e kanë kryer krimin për shkak të konflikteve të përsëritura me motive pronësie në fshatin e origjinës së autorëve. Në fund të seancës, trupi gjyqësor ka lënë në burg dy të pandehurit, të cilët akuzohen për: "Vrasje me dashje kryer në bashkëpunim", "Prodhim e mbajtje pa leje armëve luftarake e municionit" dhe "Prodhim e mbajtje pa leje armëve të gjuetisë dhe sportive".

SHKURT

Vidhni në shkollë e markete, procedohen penalisht 5 minorë
DURRËS - Policia e Durrësit ka zbuluar dhe shkatërruar një grup hajdutësh që bastisin shkollë të 9-vjeçare dhe të mesme si dhe lokale e markete të këtij qyteti. Në kuadër të operacionit të koduar "School", 5 adoleshentë nga Durrësi janë proceduar penalisht. Burime zyrtare nga policia lokale dje bënë me dije se grupi në fjalë akuzohet për 10 vjedhje që nga qershori deri në gusht të këtij viti. Bëhet fjalë për shtetasit: M.P. 15 vjeç, J.P. 17 vjeç (vëlbra me shtetasin M.P.), T.M. 16 vjeç, S.K. 17 vjeç dhe K.A. 15 vjeç, të gjithë banues në qytetin bregdetar. Procedimi i këtyre shtetasve filloi pasi policia ka bërë dokumentimin i plotë ligjor, me prova shkencore i veprimtarisë kriminale të mirorrganizuar nga këta persona.

Bastisën katedralen e Korçës, lihen në burg tre autorët

KORÇË - Gjykata e Shkallës së Parë në Korçë ka vendosur dje masën e sigurisë "Arrest me burg" për autorët e dyshuar të vjedhjes së katedralës së këtij qyteti. Bëhet fjalë për shtetasit Ronaldo dhe Lorenc Berberaj dhe 15-vjeçarin me inicialet R.SH. Tre autorët në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë vjedhur katedralen më 2 shtator, ndërsa akuzohen për "vjedhje të kryer në bashkëpunim". Sipas policisë, ata dëmtuan edhe ambientet e brendshme të saj. Në një prononcim për mediat një ditë pas ngjarjes, At Ilia Kotnami u shpreh se kjo nuk është hera e parë që ndodh. Kishat dhe objektet e kultit kanë qenë pre e grabitësve edhe më parë. At Kotnami tregoi se hajdutët kanë qëndruar në kishë gjatë meshës dhe në përfundim të saj kanë vjedhur paratë që ndodheshin në arkë. Sipas tij, autorët kishin marrë nga arka rreth 200 mijë lekë (të vjetër).

Rrëmben nga banesa 15-vjeçaren në Bulqizë, kapet i riu

BULQIZË - Një 21-vjeçar ka rënë në pranga, pasi akuzohet si bashkëpunëtor i rrëmbimit të një 15-vjeçareje në Bulqizë. Ngjarja në fjalë ndodhi më 5 shtator të këtij viti. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se Edison Dangri, në bashkëpunim me shtetasin F.T. (i shpallur në kërkim), janë futur në banesën e shtetasës me inicialet H.K., ku dyshohet se nën kërcënimin e armës kanë kanosur familjarët që ndodheshin në banesë dhe më pas janë larguar së bashku me shtetasen M.K., 15 vjeçe. Materialet procedurale do t'i referohen Prokurorisë Dibër për veprat penale "Heqje e paligjshme e lirisë", "Mbajtja pa leje e armëve dhe municioneve luftarake" dhe "Përndjekja", "Kanosja".



Universiteti
Europian i
Tiranës

maiora premunt / gjëra të mëdha na presin

TRANSFEROHU NË UET

MUNDËSIA E DYTË PËR NJË EDUKIM CILËSOR

DATA 03-13 Shtator 2018

- Juridik i Përgjithshëm
- Financë & Bankë
- Menaxhim Biznesi
- Informatikë Ekonomike
- Shkenca Politike
- Marrëdhënie Ndërkombëtare
- Psikologji
- Sociologji – Antropologji Sociale
- Komunikim – Marrëdhënie Publike
- Komunikim Dizajn


PROBLEMET MË TË ZAKONSHME TË SYVE JANË INFEKSIONET, QË MUND TË KUROHEN ME HIGJIENË TË MIRË DHE ME ANTIBIOTIKË ME PIKA.

SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETË SHTIPTARË

E martë 11 Shtator 2018



Zaimina Vasjari ekspozon gjoksin, ja fotoja që mahniti fansat




Çiljeta dhe Afërdita "mbrëmje vajzash" së bashku

BULEVARDI POLITIK



- Ish-deputetja e PD i futet biznesit, shet kollaret e Edi Ramës
- Meta përshëndet ndjekësit me dy fëmijë simpatikë në krah
- Barku i fryrë dhe dyshimet për shtatzëninë e Meghan Markle
- Gerard Depardieu në paradën e 70-vjetorit të Koresë së Veriut



Rëfëhet moderatorja: Jam e lumtur që çdo rritje e imja në ekran ka ardhur gradualisht

DALJANA SEJDIA:

Në "News 24" ndihem sikur jam në një familje të madhe

"Nuk mund të kesh sukses pa punë në grup"

Rrëfihet moderatorja: Jam e lumtur që çdo rritje e imja në ekran ka ardhur gradualisht

Daljana Sejdia:

Në "News 24" ndihem sikur jam në një familje të madhe

"Nuk mund të kesh sukses pa punë në grup"



Egla Xhemali

Suksesi zakonisht u shkon atyre që janë duke e kërkuar. Ajo punon fort dhe e ka pasion atë që bën. Në një rrëfim për suplementin "Summer pages" të "Gazeta shqiptare" vjen moderatorja simpatike Daljana Sejdia, për të ndarë me ne eksperiencën në "News 24" dhe natyrën e saj përtej ekranit. Ajo e sheh sportin si sfidë, që i sjell ndjesi të veçanta dhe është e lumtur, që i kanë besuar këtë fushë. Në punë është bashkëpunuese dhe fryma në "News 24" e motivon për të ecur përpara. Moderatorja ka zbuluar se sa më shumë punon, aq më tepër ka fat. Daljana është natyrë solare, e qeshur dhe di si të përshtatet edhe kur nuk njeh njeri. Një shpirt i bukur që e sheh botën si një pafundësi ngjyrash dhe u gëzohet gjërave që ka. Para kamerës është e qetë dhe di ta zotëroj më së miri atë. Daljana pohon se nuk ka menduar kurrë që të shkëputet nga ekranit. Nëse zgjedh të angazhohet diku tjetër padyshim që do të gjejë mënyrën si të mos shkëputet nga pasioni më i madh që ka.

Çfarë rëndësie ka sporti për ju?
Sportin në të shumtën e rasteve, e lidhin me futbollin, fushë e cila



natyre. Sfidë, sepse në këtë fushë je në çdo kohë në kërkim të informacionit dhe lajmeve të fundit. Është një fushë kaq dinamike, që karakterizohet nga zhvillime shumë të shpejta.

Si është dita jote në punë?
Nuk kam një ditë tipike dhe kjo është ajo që dua më shumë në punën time. Ndihehem sikur nuk i përkas vetëm redaksisë së programit tim. Në një ditë normale do të më gjeni duke u përgatitur për lajmet e fundit që do të transmetohen, bisedë me gazetarët sportivë për përgatitjen e skaletës ose në grim, aty ku pa diskutim duhet të jemi një orë para fillimit të programit. Në "News24" ndihem sikur jam në një familje të madhe, me njerëz bashkëpunues dhe të qeshur, që nuk të jep ndjesinë e punës, por një ambient të mbushur me miq të mirë.

TV, nëse do ishte një lloj sporti, ku duhet të ushtrohesh më shumë?
Shumë kritike ndaj vetes. Një gjë të cilën e kam konstatuar gjatë punës, duke i thënë shpeshherë vetes, që mund të kisha bërë më shumë më mirë. Më parë e kam pasur shumë të theksuar këtë kritikë ndaj vetes, e cila lidhet dhe me të qenit shumë e ndjeshme.



sigurisht është më e prekshme nga ne. Sporti është shumë më gjërë se kaq. Për mua është inspirim, argëtim, respekt, konkurrencë, aftësi. Sporti është për të gjithë, nuk është me rëndësi statusi, besimi, apo ngjyra. Sporti është një nga të paktat gjëra që bashkon, argëton dhe njëkohësisht na përcejll një mesazh: gjërat në jetë janë jo gjithmonë në dorën tonë, ndaj duhet të mësojmë nga humbjet dhe të punojmë fort, nëse duam të kemi sukses. Sporti si fushë që e lidh me punën, vijon të jetë një sfidë edhe pse kam eksperiencë të mëparshme në prezantim të programeve të kësaj



Miriam Cani pa make-up në xhirimet e klipit

Këngëtarja Miriam Cani e ka treguar gjithnjë që pëlqen më tepër të shfaqet pa make-up në përditshmërinë e saj. Edhe në fonon e fundit të publikuar në rrjete sociale e shohim këngëtarën tërësisht pa tualet. Megjithatë këtë pamje natyrale ajo ka zgjedhur ta realizojë edhe në klipin e saj më të ri, të cilin duket se Cani ka nisur ta xhirojë. Siç shohim nga kjo foto Miriami duket më në formë kurrë.



Zaimina Vasjari ekspozongjoksin, ja fotoja që mahniti fansat

Ka vetëm pak kohë që ka sjellë në jetë vajzën e saj të parë, por këngëtarja Zaimina Vasjari duket në formë të mrekullueshme e veshur me një fustan elegant të kuq. Në fonon e fundit të publikuar në rrjete sociale Zaiminën e shohim me një fustan të kuq të hapur në pjesën e dekoltesë duke u shfaqur me seksi së asnjëherë më parë.



Kam vendosur të bëj një pauzë, edhe pse herë pas herë e gjej veten duke qenë shumë kërkuese ndaj vetes, por kjo pauzë më ka bërë të shijoj arritjet e mia dhe sigurisht të filloj të besoj që njerëzit që kanë besim tek ajo që mund të bëj nuk është e rastësishme, por vjen si rezultat i punës sime.

Çfarë tipi jeni kur gjendeni në festa me njerëz që nuk i njeh?

Nuk i kam qejf skenarët ku duhet të kem patjetër një mik apo mikeshë që po shkon në të njëjtin vend me mua për t'u ndërjerë komode në një festë apo organizim. Kur je në ambient me të panjohur, sigurisht çdo njëri prej nesh është paksa i pasigurt dhe në siklet. Unë thjesht sillem normalisht. Di të shijoj dhe shoqërinë e vetes sime, ndaj nuk është kusht të flas me njerëz apo patjetër të kem shoqëruar. Zakonisht nuk më ka ndodhur të shkoj në ambiente me njerëz krejtësisht të panjohur, por, nëse ndodh jam natyrë ekstroverte, e gatshme për të njohur njerëz të rinj, adaptohem shpejt dhe jam e shoqërueshme.

Veshjet që e di se të tregojnë bukur?

Fustane stil 'pencil', që rrinë ngjitur pas trupi dhe japin një siluete që gjithnjë bie në sy. Me një gjatësi nën gju, këto fustane janë të sofistikuar dhe shumë feminine, të përshatshme për çdo moment të ditës, apo darkës.

Si del në punë shpirti i jot i skuadrës?

Në punën në televizion nuk mund të kesh sukses pa punë në grup. Çdo projekt që kam marrë përsipër, e kam konsideruar si një punë, e cila kërkon pa diskutim një mbledhje forcash në mënyrë që të ketë sukses. Për fatin tim të mirë, kam punuar gjithnjë me

kolegë që janë bashkëpunues dhe të predispozuar për të të ndihmuar. Unë karakterizohem nga një natyrë shumë miqësore, ndaj përpara se të jem një kolege, jam një mikeshë shumë e mirë. Shpirti im i skuadrës, karakterizohet nga pozitiviteti, optimizmi dhe inkurajimi i vazhdueshëm i stafit.

Sa individualiste jeni?

Jam një miks mes natyrës kolektivistike dhe individualiste. Të dyja janë të nevojshme, në kohë, kontekste të ndryshme. Një projekt i profilit tim, është i përmbushur nga i gjithë grupi, por një zgjidhje kreative vjen nga një refleksim individual.

Çfarë bën për ta zotëruar kamerën e TV?

Jam "unë". Para kamerës jam e relaksuar, sa më natyrale pa asnjë sforco. Kur jam para kamerës, nuk mendoj asgjë tjetër, veçse të jem sa më afër dhe interaktive me audiencën.

Synimi drejt të cilit po shkon?

Çfarëdo lloj gjëje që Zoti ka përcaktuar për mua. Jam e lumtur që çdo rritje e imja në ekran ka ardhur në mënyrë graduale dhe në kohën e duhur. Tashmë jam profilizuar në programe "entertainment" dhe sporti është një dimension që nuk ka fund. Ndihej mirë me programin që më është besuar, se çfarë ka rezervuar e ardhmja, jam e hapur për sfida të reja.

Propozimi që do të tundonte për ta lënë punën në media?

Profesioni im është ekonomiste, por nuk e kam ushtruar asnjëherë. Për sa kohë unë punë në media e kam si fillim pasion, nuk besoj që propozim tjetër do të më bënte të braktisja punën që bëj aktualisht. Edhe nëse një ditë do të zgjedh të angazhohem në ndonjë fushë tjetër, do gjej patjetër një mundësi, që paralelisht të kem një lidhje me median.

Çiljeta dhe Afërdita "mbrëmje vajzash" së bashku

Këngëtarja Afërdita Dreshaj prej disa ditësh ndodhet në Shqipëri. Pas dasmës së saj të realizuar gjatë muajit qershor, duket se bukuroshja ka vendosur ta kalojë disa ditë në Tiranë. Pas takimit me disa nga miqtë e saj ajo ka kaluar një mbrëmje vajzash me këngëtarën Çiljeta Xhilaga. Dy vajzat e njohura të showbiz-it bashkë me mikeshat e tyre kanë vendosur t'ia dedikojnë mbrëmjen vetëm njëra-tjetrës dhe këtë fakt e kanë treguar edhe në rrjete sociale. Gjithashtu, me to është bashkuar edhe djali i Çiljetës, Fernando.



Ish-deputetja e PD i futet biznesit, shet kollaret e Edi Ramës

Ish-deputetja e PD-së, Lajla Përnaska tashmë merret me biznes. Demokratja është pronare e firmës "Onus", e cila prodhon kollaret 3 D. "VIP TIE 3D" quhet linja, që hodhi një seri kollaresh në treg me figurat e kryeministrit Rama. Këto të fundit janë reklamuar fuqishëm nga kryeministri Edi Rama muaj më parë, teksa shfaqej i buzëqeshur duke mbajtur në duar kollaret me figurina. Mesa duket, kryeministri Rama dhe ish-deputetja demokrate kanë raporte të mira me njëri-tjetrin, aq kohë sa kanë shkuar deri tek imazhi e reklama. Sigurisht, në emër të biznesit, që përkthehet automatikisht në para.



Meta përshëndet ndjekësit me dy fëmijë simpatikë në krah

Për 73 vjet nuk kishte shkollë, por sot populli i Sheldisë, në njësinë administrative Guri i Zi, që i përket qytetit të Shkodrës, do të ketë shkollën e vet në themelet e të vjetrës. Dom Niko Sheldija shkruan se ndokush mund të mendojë se shteti ka investuar për ngritjen e kësaj shkolle, "por e vërteta është krejt ndryshe". "Për 27 vjet, shteti nuk ekziston për këtë popull bujar, fisnik dhe të lënë pas dore", shkruan dom Niko Sheldija, i cili thotë se kthehet gjithmonë me mall në vendlindjen e tij. "Falënderoj Motrat Salvatoriane që nuk lejuan të shkeputet një histori 240-vjeçare të shkollës në Sheldi, ku mësuesi i parë ishte dom Nikoll Kançi, që mësoi gjuhë. (sipas shënimeve Sheldi 8 janar 1778)", shkruan kataliku në rrjetet sociale.



BULEVARDI POLITIK

Në merrni seriozisht! 😊

Barku i fryrë dhe dyshimet për shtatzëninë e Meghan Markle

Që prej martesës së Meghan Markle me princin Harry, mediat rozë flasin për një shtatzëni të saj. Sa herë që dukeshin bën daljet e saj në publik dhe kur vihet re ndonjë ndryshim i vogël në trupin e saj flitet për një shtatzëni. Një ditë më parë Meghan dhe Harry morën pjesë në një veprimtari bamirëse në Londer, "100 Day to Peace" për mbledhjen e fondeve për veteranët e luftës. Dukesha kishte veshur një fustan blu tepër elegant, që tek pjesa e barkut duket pak i fryrë dhe të gjithë menduan për të shtatzëni të mundshme të saj. Megjithatë, lumturia e fansave për një shtatzëni të mundshme nuk zgjati gjatë, sepse një burim ka thënë për "Us Weekly" se Harry dhe Meghan nuk janë ende gati për t'u bërë prindër.



Gerard Depardieu në paradën e 70-vjetorit të Koresë së Veriut

Aktori i njohur francez, Gerard Depardieu ka marrë pjesë në Pyongyang për festimet e 9 shtatorit, në 70-vjetorin e themelimit të Koresë së Veriut. Aktori i njohur është shfaqur papritur në hotelin "Yanggkdo", ku kanë qenë të ftuar rreth 130 gazetarë për të ndjekur paradën. Depardieu ka asistuar më pas në festimet e programuara për festën duke shtuar "që do të takojë dikë nga krerët e lartë të shtetit, më të lartin", duke lënë të kuptohet që do takohet me Kim Jong Un.



Trashëgimtarët duhet të plotësojnë dokumentet në Drejtorinë e Pagesave

Ish-të përndjekurit, 650 përfituesit e kështit të dytë

Afati për plotësimin e dosjes, 3 muaj

Ornela Manjani

Rreth 650 trashëgimtarë të ish-të dënuarve politikë që presin të marrin kështin e dytë duhet të plotësojnë dokumentacionin që u mungon në dosje për të marrë më pas paratë. Lista është bërë publike dhe nga Ministria e Financave. Bëhet fjalë për përfitues të kategorisë joparësore që do të trajtohen me dëmshpërbim, por që sipas këtij dikasteri duhet të dorëzojnë dokumentet. Ministria e Financave u kërkon përfituesve të kështit të dytë të dorëzojnë në Drejtorinë e Pagesave numrin e logarisë për të marrë dëmshpërbimin.

DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shuma e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet, duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi

ndryshim të identitetit, (emër/mbiemër), apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një gërmë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet, emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në rast se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet

e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq, është i domosdoshëm një vendim fakti gjykatë që vërteton vendqeljen, plus një certifikatë negative të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës dokumentëse dhe ky fakt vërteto-

het nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin që Ministria e Financave bën për të sqaruar trashëgimtarët e ish-të dënuarve që nuk kanë marrë ende dëmshpërbimin.

PËRFITUESIT E KËSHIT TË DYTË

Table with columns: EMER, MBEMER, LIE, NADIRE, ALI, IBRAHIM, KOPER, PERSONAL, IFKATE, FKATE, DESHMI, TRASHI, PROKURE. Lists names and status for beneficiaries.

Table with columns: VALDETE, ZALLI, VALENTIN, MADANI, VALMIRA, RENHAJ, BESNIK, RENHAJ, FLORIN, RENHAJ, VALBONE, RENHAJ, SHKELQIM, RENHAJ, ZEF, MARKU, DAVA, NIKOLLI, LULA, NIKOLLI, PJETER, MARKU, ANDONETA, PAHRISANTHU, PAVLI, PAHRISANTHU, KOCO, PAHRISANTHU, IRINI, ORGOCKA, LUVIGJ, VUKAJ, PJETER, VUKAJ, PRENDE, NILAJ, GJON, VUKAJ, NDIJE, VUKAJ, KATRINE, TINAJ, TEPTA, DEROMEMAJ, HAJDAR, DEROMEMAJ, PETRIT, DEROMEMAJ, SKENDER, DEROMEMAJ, ILIR, DEROMEMAJ, ESMIA, SHASKA, FETI, DEROMEMAJ, PAL, GURI, MARIJE, DEMA, KATRINE, VATAJ, PRENDE, MHILLI, ANGHJELINA, DEMA, LEZE, PJETRI, GJELOSH, GURI, VLADI, ABDULLAH, BERHAMI, SHPETIM, BERHAMI, FATBARDE, BERHAMI, ROLAND, BERHAMI, BESNIK, BERHAMI, SULEJMAN, BERHAMI, ERIOLA, MISKU, DORINA, BERHAMI, BUKURRIJE, BATHORJA, NEXHMI, BERHAMI, BEDRIJE, KERTUSHA, HUZRIJE, NEZHA, QAZIM, NDEU, HAZIS, NDEU, ABDI, NDEU, ARSHI, NDEU, KADIFE, HOKHA, ALLTANE, HOKHA, HAJRIJE, ALLA, KULLAFI, AISHA, KULLAFI, AHMET, ALLA, KHANE, BARDHI, NEXHMIJE, LALA, MEREME, BALLA, HANIFE, SINA, ARIFE, HOKHA, SALI, HOKHA, NEFARET, HOKHA, VANGJEL, THOMAJ, FATIME, DOLLANI, KADENE, ZENELI, RIZA, RUSI, ZYLHA, RUSI, SIDIKI, RUSI, ABDYL, RUSI, EQEREM, RUSI, THABIT, RUSI, BAHRI, RUSI, MANKULE, RUSI, ALIDUE, BREGU, MIRELA, VRAPI, ELIRA, BREGU, CLIRIM, BREGU, KLAUDI, BREGU, ABDI, NESIMI, VEHIT, NESIMI, REMZI, NESIMI, HASNIE, SULA, FEMIE, LAMI, ESMARIE, DUMJANI, VELI, NESIMI, NASLIE, LAHI, HAXHI, NESIMI, MIBREME, LAHI, ARZE, HANZAJ, MAHMUDIJE, SULA, ALLTANE, HALILI, VEJBI, SULA, ZARIE, XHENALLA, KADIFE, ABAZAJ, NURIE, RHAJA, ISMAIL, ABAZAJ, BEZIBRI, ABAZAJ, BARI, ABAZAJ, NAIMI, KARAJ, LATIF, ABAZAJ, DYLIBRE, SEFERI, SAITKOSTA, QAMIL, GJIZI, MAKRULE, XHONDA, BUKURRIJE, GJIZI, FQIRI, GJIZI, SHKELQIM, GJIZI, MIBERIA, GJIZI, NESTREITE, XHULLIMA, BEDRI, GJIZI, ILIRIANA, LIKA, MIRRETA, GJIZI, VATH, GJIZI, DHURATA, GJIZI, SHPETIM, GJIZI, ENVER, GJIZI, SULLTANE, BOJA, DRITA, LLESHAJ, VJOLLCA, FISHTA, ARBEN, GJINI, VERA, HALILI, ENDRIETA, RADOVICKA, ENRIK, GJOKA, GENCI, GJOKA, HAJDAR, HAJDAR, HAJDAR, HAJDAR, SURJA, MIRVET, GJURP, MIRVET, PEJAZIT, MIRVET, SABRI, MIRVET

Table with columns: RIZA, RUSI, ZYLHA, RUSI, SIDIKI, RUSI, ABDYL, RUSI, EQEREM, RUSI, THABIT, RUSI, BAHRI, RUSI, MANKULE, RUSI, ALIDUE, BREGU, MIRELA, VRAPI, ELIRA, BREGU, CLIRIM, BREGU, KLAUDI, BREGU, ABDI, NESIMI, VEHIT, NESIMI, REMZI, NESIMI, HASNIE, SULA, FEMIE, LAMI, ESMARIE, DUMJANI, VELI, NESIMI, NASLIE, LAHI, HAXHI, NESIMI, MIBREME, LAHI, ARZE, HANZAJ, MAHMUDIJE, SULA, ALLTANE, HALILI, VEJBI, SULA, ZARIE, XHENALLA, KADIFE, ABAZAJ, NURIE, RHAJA, ISMAIL, ABAZAJ, BEZIBRI, ABAZAJ, BARI, ABAZAJ, NAIMI, KARAJ, LATIF, ABAZAJ, DYLIBRE, SEFERI, SAITKOSTA, QAMIL, GJIZI, MAKRULE, XHONDA, BUKURRIJE, GJIZI, FQIRI, GJIZI, SHKELQIM, GJIZI, MIBERIA, GJIZI, NESTREITE, XHULLIMA, BEDRI, GJIZI, ILIRIANA, LIKA, MIRRETA, GJIZI, VATH, GJIZI, DHURATA, GJIZI, SHPETIM, GJIZI, ENVER, GJIZI, SULLTANE, BOJA, DRITA, LLESHAJ, VJOLLCA, FISHTA, ARBEN, GJINI, VERA, HALILI, ENDRIETA, RADOVICKA, ENRIK, GJOKA, GENCI, GJOKA, HAJDAR, HAJDAR, HAJDAR, HAJDAR, SURJA, MIRVET, GJURP, MIRVET, PEJAZIT, MIRVET, SABRI, MIRVET

Table with columns for names and various status indicators (V, X, P, VV, etc.). Includes names like ILIR, MIRVET, BESA, KHEMLE, IMER, etc.

Table with columns for names and various status indicators. Includes names like PASHKE, ZEF, GJON, MANOLA, GJEGA, etc.

Table with columns for names and various status indicators. Includes names like GJYSTINA, GJONI, GONXHE, CUNI, etc.

Përfaqësuesit e Luginës kërkojnë rezolutë për bashkim me Kosovën

Thaçi: Më ka dënuar Serbia, s'mund të vizitoj Luginën

Kusari: Presidenti po luan lojë të ndyrë në Preshevë

Në kulmin e debateve dhe diskutimeve për çështjen e kufijve, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, sqaroi arsyen se pse nuk mund të vizitonte komunat; Preshevë, Bujanovc e Medvegjë. "Nuk mund të vizitoj Luginën e Preshevës, pasi jam i dënuar në mungesë nga Serbia", ka thënë Thaçi. "Atë dënim Serbia nuk ma ka falur kurrë dhe as unë nuk e kam kërkuar atë falje. Unë nuk mund t'ia mësyj kufirit dhe të ballafaqohem fizikisht me policinë e Serbisë. Aktualisht, rrethanat janë të atilla që Beogradi nuk e sheh të dobishme e as të arsyeshme prezencën time atje. Nuk e kam bërë kurrë kërkesën, por e imagjinoj sjelljen e tyre", tha ai. Pas takimit me përfaqësuesit e komunave Preshevë, Bujanovc e Medvegjë në Prishtinë, Thaçi shtoi se: "Por, pavarësisht nëse e vizitoj apo jo, unë do të punoj ngushtë me përfaqësuesit e Preshevës, Medvegjës e Bujanovcit. Banorët e atjeshëm janë banorët më të diskriminuar në Evropë. Kosova nuk është vetëm Hashim Thaçi dhe ata që nuk mund të shkojnë në Serbi, sepse ishin bartës të luftës çlirimtare. Por, mendoj se ata që mund ta vizitojnë, mund ta bëjnë këtë pa pasur asnjë pasojë", tha presidenti i Kosovës. Nga ana tjetër, Thaçi i ka dhënë edhe njëherë mbështetje, siç ka thënë ai, vullnetit të shprehur të shqiptarëve të Luginës së Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit për t'iu bashkuar Kosovës. Njëherësh, ai ka mbështetur edhe përfshirjen e përfaqësuesve të këtyre komunave në delegacionin e Kosovës në kuadër të dialogut me Serbinë. Sipas Thaçit, lënia e këtyre tri komunave brenda territorit të Serbisë, ishte një padrejtsi historike që duhet të korrigojë. Këto komente, Thaçi i bëri gjatë një konference për media pas një takimi që zhvilloi me përfaqësuesit e tri komunave nga Serbia, Presheva, Medvegja e Bujanovci. Thaçi tha se në kuadër të dialogut dhe marrëveshjes paqësore me Serbinë, të përfshihet edhe çështja e këtyre tri komunave dhe vullneti i qytetarëve të atjeshëm për t'iu bashkuar Kosovës. Ai ftoi Kuvendin, liderët politik të Kosovës dhe partitë politike që ta mbështesin angazhimin e tij që këto tri komuna t'i bashkohen Kosovës. Ai tha se rezoluta do t'u dorëzohet që gjithë liderëve politik në Kosovë, nga presidenti deri te kryetarët e partive politike. Ndërkohë deputetja në Kuvendin e Kosovës, Mimoza Kusari-Lila përmes një postimi në rrjetet sociale ka reaguar pas takimit të Hashim Thaçit me përfaqësuesit në Luginën e Preshevës. Kusari shkruan se presidentit të Kosovës nuk i mjafton loja e ndyrë që po



Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi

HASHIM THAÇI:

"Nuk mund të vizitoj Luginën e Preshevës, pasi jam i dënuar në mungesë nga Serbia. Unë nuk mund t'ia mësyj kufirit dhe të ballafaqohem fizikisht me policinë e Serbisë. Aktualisht, rrethanat janë të atilla që Beogradi nuk e sheh të dobishme e as të arsyeshme prezencën time atje. Nuk e kam bërë kurrë kërkesën, por e imagjinoj sjelljen e tyre", -tha Thaçi.

Johnson fton maqedonasit të votojnë në referendum

Senatori amerikan: T'i japim hapësirë Kosovës dhe Serbisë të arrijnë marrëveshje

Senatori ameri kan, Ron Johnson, thotë se zgjidhja e problemeve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të gjendet nga të dyja palët. Senatori Johnson, i cili qëndroi të dielën në Prishtinë, do të shkojë të hënën në Beograd, për të transmetuar siç tha, mbështetjen e Shteteve të Bashkuara për gjetjen e një zgjidhjeje, që "nuk është aspak e lehtë". "Pasi të kenë arritur çfarëdo marrëveshje, ne do ta shohim atë për të parë nëse kemi ndonjë shqetësim dhe do të përçojmë ato shqetësime, por tani duam t'iu japim Kosovës dhe Serbinë hapësirë nën ombrellën e Bashkimit Evropian, në bisedimet e drejtuara në Bruksel që të gjejnë zgjidhjen. Senatori, nga ana tjetër, u ka bërë thirrje edhe qytetarëve të Maqedonisë që të dalin dhe të votojnë në referendumin e 30 shtatorit. Pas takimit në Shkup me kryeministrin Zoran Zaev, senatori Johnson tha se marrëveshja e Prespës është mënyra e vetme për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO.



luan me qytetarët e Kosovës, por këtë lojë tani e ka zhvendosur në Luginën e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës. Sipas saj, kjo manovër e Hashim Thaçit duhet të ndalet urgjentisht.

Koçijanciq flet për "ndryshimin e kufijve" e negociatat

Bashkimi European kundër Vuçiqit: Mos bëni lavdërimë për politikën e Millosheviçit

Pas fjalimit të presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, në Kosovë, gjatë të cilit, Slobodan Millosheviçin e cilësoi si "udhëheqës të madh, me qëllimet më të mira", ka reaguar Bashkimi European. Maja Koçijanciq, zëdhënëse e BE-së e ngarkuar me çështjet e Ballkanit Perëndimor, tha se "nuk guxon të lihet hapësirë për dykuptimësi apo lavdërim" të atyre që kanë mbështetur politikën e Millosheviçit dhe veprimet e tij. "Vendimet e gjykatave vendase dhe ndërkombëtare në këtë drejtim janë shumë të qarta", -tha Koçijanciq. Ajo theksoi se të gjitha vendet



në Ballkanin Perëndimor kanë perspektivë evropiane dhe për këtë arsye "do të duhet të jenë në përputhje me parimet e BE-së, përfshirë pajtimin dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore", raporton rel. Vuçiq ka qëndruar në Kosovë

fundjavën e kaluar, ndërsa fjalimin e ka mbajtur në Mitrovicën e Veriut. Gjithashtu, Koçijanciq ka deklaruar se Bashkimi European pret që Serbia dhe Kosova të vazhdojnë dialogun me të njëjtin angazhim si më parë. Maja Koçijanciq vuri në dukje se BE ka theksuar shumë qartë parimet e negociatave. "BE po punon për një marrëveshje të bazuar në të drejtën ndërkombëtare, e cila do të ishte realiste dhe e pranueshme për të dy palët. Qëllimi është një marrëveshje ligjërishit e detyrueshme që do të zgjidhë të gjitha çështjet e hapura", -tha Koçijanciq.

KFOR: Prishtina shmangu vizitën e Vuçiqit në Drenicë

Komandanti i KFOR-it, Salvatore Cuoci deklaroi se KFOR ishte i gatshëm që të ndërhynte gjatë vizitës së presidentit të Serbisë në Kosovë, Aleksandar Vuçiq. "Së pari policia, pastaj EULEX dhe pastaj ne. Ne ishim të gatshëm për të ndërhyrë në të gjitha fushat në të cilat ishte presidenti në mënyrë që të ketë një mjedis të sigurt. Gjithçka ishte në rreg-



ull, përveç në fshatin Banjë", është shprehur Cuoci, raportojnë mediat

serbe. Sipas komandantit të KFOR-it, askush nuk ishte në rrezik nga kjo vizitë. "Çështja kryesore është siguria e Presidentit, dhe në qoftë se kjo nuk është e mundur duhet të shmangim këtë vizitë. Kështu që unë mendoj se kjo ishte diçka e mençur për të shmangur këtë vizitë, për të shmangur një situatë të ndryshme", -ka vlerësuar ai.

Arrestohet për drogë, Vetëvendosja pezullon anëtarin e saj

Pas arrestimit të Rediart Cankajt, anëtarit të Lëvizjes Vetëvendosje, ka reaguar dega në Belgjikë. Përmes një reagimi publik dega e VV-së në Belgjikë ka bërë me dije se Cankaja do të pezullohet nga lëvizja. Mediat belge raportuan se Rediart Cankaja u arrestua për përfshirje në trafik drogë. Megjithatë, pas raportimit nga media dhe në konsultim



tim me përfaqësuesit e Qendrës në Belgjikë, Komisioni Disiplinor i Lëvizjes VETËVENDOSJE!

ENDOSJE! ka nisur sot procedurën për shqyrtimin e rastit të Rediart Cankajt dhe ka marrë vendim në mënyrë unanime për pezullimin e menjëhershëm të anëtarësisë dhe angazhimit të tij në Lëvizjen VETËVENDOSJE! Komisioni Disiplinor do të pres vendimin e Gjykatës për të shqyrtuar masën disiplinore të përjashtimit lidhur me këtë rast.

Dje në "Reporter.al"

Fjalimi i Vuçiçit në Kosovë promovoi një fantazi të rrezikshme

Nga Milos Ciric

(vijon nga faqja 1)

... me fjalimin e famshëm të Sllobodan Millosheviçit në vitin 1989 në vendin e betejës së shekullit të 14-të të Kosovës, pas së cilës Millosheviçi shkatërroi Jugosllavinë.

Fjalimi i Vuçiçit duhet të ofronet një ton më paqësor dhe pajtues, por, ndërsa arriti ta mbante "të pranueshëm" për një audiençë perëndimore, ai njëkohësisht i qëndroi i vërtetë politikave që ai mbështeti gjatë agresionit të udhëhequr nga Serbia në vitet 1990, kur ai ishte një radikal i ri nacionalist.

Një manipulues politik me përvojë, Vuçiçi arriti ta bënte këtë duke marrë një ton kërcënues në të njëjtën kohë duke dërguar të ashtuquajturat "mesazhe paqeje", që kënaqën dishepujt e tij nga qeveria dhe partia e tij, të cilët të gjithë vrapuan nëpër media për të thënë se sa i mrekullueshëm ishte fjalimi i presidentit.

Edhe përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar ishin të kënaqur me atë që dëgjuan nga Vuçiçi. Ata e vlerësuan atë, ndoshta sepse të gjithë u ndjenë të lehtësuar, sepse nuk e përdori këtë mundësi për të ndezur skenën dhe për t'i bërë thirrje njerëzve të marinarit.

Por, pavarësisht nga lavdërimet dhe vlerësimet pozitive që ai mori, ne e njohim më mirë Vuçiçin dhe e dimë se sado boshë, fjalët e tij ende kanë një fuqi toksike. Kjo është për shkak se ne e kuptojmë që ai flet duke përdorur një gjuhë të koduar që një vesh pa eksperiencë mund ta ngatërrojë me një fjalim normal.

Pra, kur Vuçiçi u tha serbëve të Kosovës të cilëve u drejtua të dilen: "Po, po, presidenti i Kosovës Hashim Thaçi është shqiptar dhe unë duhet të flas me të", ky ishte një pasqyrim i racizmit të lashtë serb ndaj shqiptarëve të Kosovës. Sepse shqiptarët nuk janë njerëz që janë "të denjë" për të folur, por që duhet të menaxhohen, qeverisen ose shkatërrohen.

Kjo është arsyeja pse gjuha e Vuçiçit është ende e rrezikshme – ai vazhdon të mbështesë ndarjen dhe paragjykimet duke ushqyer shpresat e rreme nacionaliste mes serbëve. Kjo vlen për serbët kudo, por më e rëndësishmja për ata nga Kosova dhe Bosnja. Ka një arsye të mirë përse Vuçiçi nuk u tha serbëve të Kosovës se Prishtina është kryeqyteti i tyre, ashtu siç nuk i ka thënë kurrë serbëve të Bosnjës se Sarajeva është kryeqyteti i tyre.

Vuçiçi megjithatë tha se Serbia mori pjesë në luftëra, ndryshe nga qëndrimi zyrtar i Beogradit se ajo nuk ishte përfshirë kurrë drejtpërdrejt në konfliktet e viteve 1990 në Bosnjë dhe Kroaci. Kjo pjesë e fjalimit të tij ishte, gjithashtu, e maskuar si një mesazh i koduar,



kur ai parafranoi një varg nga një këngë lufte që serbët i këndonin Millosheviçit në Gazimestan në vitin 1989.

Menjëherë pasi tha se "tre luftëra janë përmendur në këngë, por ne kemi pasur edhe disa të tjera", Vuçiçi "e mbuloi" veten duke thënë: "Ky nuk ishte faji ynë, por jo edhe tërësisht i të tjerëve". Zyrtarisht dhe jo zyrtarisht, ne i ndihmuam vëllezërit tanë – serbët vdiqën për Kninin në Kroaci, për Sarajevën, për Prishtinën."

Por ajo që ai duhet të kishte thënë është se Serbia përveçetosi Ushtrinë Popullore Jugosllave për të fituar luftëra kundër Kroacisë, Bosnjës dhe Kosovës me ndihmën e njësjes paraushtarake dhe policore serbe, së bashku me bandat vullnetare që u bënë pjesë e së njëjtës ushtri, trupat e të cilave kryen qindra krime lufte dhe krime kundër njerëzimit dhe iu ngarkuan si detyrë fushata gjenocidit dhe spastrimi etnik.

"Çështje të papërfunduara" nga luftërat e viteve '90

Përveç nesh – shumica e qytetarëve serbë që kurrë nuk kanë rështur së mbështeturi politikat e Millosheviçit dhe pasardhësve të tij – ne kemi BE dhe SHBA-në për të falënderuar për Vuçiçin e sotëm, pasi ata e kanë normalizuar më tej atë, duke e ditur shumë mirë se ku çuan politikat dhe veprimet e tij në të kaluarën dhe me çfarë kostojte.

Programi i Vuçiçit sot është plotësisht në përputhje me politikën e Serbisë të viteve 1990, të cilat synonin të krijonin një "Serbi të Madhe", e njohur edhe si "Serbia Qjellore" – ideja që të gjithë serbët duhet të jetojnë së bashku në një shtet, e cila ishte e mundur vetëm nëse të gjitha etnitë e tjera do të vriteshin ose dëboheshin nga territori.

Vuçiçi vetëm sa e ka denoncuar atë politikë duke thënë: "Puna ime nuk është miti, ëndrra, halucina-

cionet apo vizioni i shtrembër i Kosovës pa shqiptarë apo Kosovës pa serbë. Puna ime është realiteti. Ajo që është sot, këtu dhe tani, në Kosovën e sotme, në Serbinë e sotme, jo në ndonjë Serbi qiellore. Ne ranë nga ai qiell. Ne ramë dhe u lënduam keq. Kokat tona janë të mbuluara me gjak, krahet tanë janë thyer."

Por përsëri, Vuçiçi nuk po thoshte të vërtetën. Nuk kishte asnjë "vizion" të Kosovës pa serbë, vetëm atë që ai e mbështeti për kaq shumë kohë – Kosova pa shqiptarë. Për referencën të hollësishtme se si do të realizohej ky vizion në Kosovë, lexuesi këshillohet që të konsultohet me programin e Partisë Radikale Serbe gjatë luftërave, kur sekretari i përgjithshëm i saj ishte Aleksandër Vuçiçi.

Ajo që Vuçiçi duhet të kishte thënë është se ne nuk arritëm të shkatërrojmë çdo jo-serb që doli në rrugën tonë ndërsa përpiqeshim të krijonim një shtet etnik të pastër, që luftuam kundër të gjithë botës dhe humbëm.

Ai mund të kishte shtuar se sot po vuajmë pasojat e të gjitha mitorive që kemi kryer dhe se ka ardhur koha që ne të pranojmë realitetin e vështirë, të pranojmë të kaluarën tonë të kohës së luftës, të kërkojmë ndjesë dhe të përpiqemi të jetojmë në paqe me pjesën tjetër të botës.

Vuçiçi e di këtë, por faktet nuk e ndalojnë atë që të mos vazhdojë të mbajë shpresat nacionaliste midis serbëve rreth faktit sesi "rrethanat historike" do ta lejojnë Serbinë të bëhet përsëri "e plotë".

Kjo ide toksike që ka kushtuar kaq shumë jetë – unifikimi i "të gjitha trojeve serbe" në një "Serbi të madhe" dhe të pandashme – është ajo që Vuçiçi, ashtu si Millosheviçi 30 vjet më parë, u ofroi serbëve të Kosovës.

Ai nuk ofroi paqe me shqiptarët e Kosovës, sepse po ta bënte këtë, ai do të duhej të kërkonte falje për

të gjitha krimet e pahijshme kundër popullatës civile të Kosovës.

Ai do të duhej t'u thoshte serbëve të Kosovës që ta kthenin shikimin e tyre nga Prishtina, me mbështetjen e Beogradit, dhe të integroheshin në shoqërinë kosovare – të njëjtën gjë që ai duhet t'i kishte thënë serbëve në Republikën Srpska me shumicë serbe të Bosnjës, por që ai, si çdo tjetër sundues tjetër serb para tij, nuk e ka bërë kurrë.

Fjalimi i Vuçiçit në Kosovë tregoi se projekti "të gjithë serbët në një shtet" mbetet parimi politik kryesor i Serbisë.

Kjo është arsyeja pse Kosova dhe Bosnja janë të pandashme në projektin nacionalist serb; kjo është arsyeja pse të dyja këto "çështje" ende konsiderohen "të pazgjidhura"; kjo është arsyeja pse ne dëgjojmë gjithnjë e më shpesh se Serbia duhet të luftojë në "të dyja frontet", sepse ato janë të ndërlidhura ngushtë dhe konsiderohen si çështje të papërfunduara nga vitet 1990.

Lavdërim për Millosheviçin, një "lider i madh serb"

Pavarësisht të gjitha përpjekjeve të dështuara për të bashkuar të gjithë serbët në një shtet mbi kufomat e boshnjakëve, kroatëve dhe shqiptarëve, Vuçiçi u duartkroi se vazhdoi repertorin e zakonshëm "Kosova është Serbi" të hartuar nga elita intelektuale serbe në fillim të viteve 1980.

Duke e ditur mirë se askush nuk guxon ta kritikojë atë pasi në pamjen të parë ai duket se tha disa fjalë pajtuese, Vuçiçi u kthye thelbit të fshehtë të fjalimit të tij ndërsa vlerësoi "lidhshipin" e Sllobodan Millosheviçit.

"Millosheviçi ishte një lider i madh serb, qëllimet e të cilit ishin sigurisht për më të mirën, por rezultatit tona ishin shumë të dobëta. Jo sepse ai e donte atë, por sepse dëshirat tona ishin joreale, ndërsa nënligjshmëria dhe nënvlerësimat in-

teresat dhe aspiratat e kombeve të tjera", tha ai. "Për shkak të kësaj, paguam qmimin më të madh dhe më të rëndë. Nuk jemi bërë më të mëdhenj."

Vetëm kjo pjesë e fjalimit të Vuçiçit duhet të kishte alarmuar BE-në dhe Perëndimin në përgjithësi, sepse ajo tregoi ngjyrat e tij të vërteta dhe tregoi se ai po vazhdon të njëjtën linjë të ashpër nacionaliste që shkatërroi miliona jetë.

Fjalimi i tij në Kosovë mund të kishte qenë momenti që ai të ndahej nga politikat që Millosheviçi zbatoi gjatë viteve 1990 dhe që Vuçiçi mbështeti në atë kohë.

Për fat të keq, por jo çuditërisht, ai mbeti ai që ishte gjithmonë, dishepulli dhe pasardhësi i kreut të Partisë Radikale Serbe Vojislav Shesheli dhe i vetë Millosheviçit; një njeri që nuk tërhoqi kurrë mbrapsht ndonjë gjë që bëri apo tha.

Vuçiçi vazhdoi të fliste të njëjtën gjuhë të ngjashme me referencat e tij mitologjike që janë të njohura për serbët, por që i ngatërrojnë të tjerët. Dhe pavarësisht dekadave të shkatërrimit, ai ia doli mbanë dhe tani po lavdërohet nga të gjitha anët.

Ai nuk kishte para tij një turmë të madhe siç ishin dhjetëra mijëra njerëzit që erdhën për të dëgjuar Millosheviçin që mbante fjalimin e tij në Gazimestan në vitin 1989, por ai mori miratimin e atyre që mbështesnin Millosheviçin atëherë.

Vuçiçi në thelb i flori serbët e Kosovës – dhe për këtë arsye të gjithë serbët kudo në rajon – të vazhdojnë të endërrtojnë për një "Serbi të madhe", duke i inkurajuar kështu ata që të adhurojnë kriminelët e luftës dhe, në mënyrë të vazhdueshme, të mohojnë krimet që janë vërtetuar nga gjykatat vendase dhe ndërkombëtare.

Mesazhi i tij ishte i qartë – s'kemi asgjë për të cilën të kërkojmë ndjesë apo për të cilën duhet të na vijë turp. Nuk ka asgjë që nuk mund ta durojmë, për sa kohë që qëllimi ynë është ajo që imagjinojmë dikur Millosheviçi, një "lider i madh serb".

Të gjithë e dinim çfarë të prisnim nga fjalimi i Vuçiçit, por ishte vërtet e habitshme ta dëgjoje atë të mbronte aq hapur Millosheviçin dhe trashëgiminë e tij, si edhe të mos dëgjoje ndonjë lloj dënimi nga kushdo që dëgjoje atë që tha ai.

Në mungesë të një dënimi të tillë, një tjetër mundësi u humb nga ata që kishin ndikim të presidentin serb për të ushtruar presion më të fortë ndaj tij që të ulë retorikën ndërsa me të cilën ai dikur frymëzoi shumë njerëz që të merrnin armët dhe të shkonin në luftë.

* **Mendimet e shprehura në sektorin e Opinioneve janë vetëm ato të autorëve dhe jo domoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e BIRN.**

Dështon skema e Panuçit. Nuk bëmë asgjë derisa pësuam golin e parë



Jeton Selimi

Pa ide dhe pa forcë, Skocia na thyen lehtësisht

Autogoli i Gjimshitit dhe Naismith vulosën ndeshjen

Shqipëria pësoi humbjen e parë në Ligën e Kombeve, duke u mposhtur në "Hampden Park" nga Skocia 2-0. Trajneri Christian Panuçi e nis këtë takim me tre ndryshime në formacion, edhe pse tre ditë më parë fitoi 1-0 me Izraelin. Pasiguritë që kishte ai i tregoi qartë në fushë dhe në fund mori një shuplakë nga skocezët. Me këtë humbje kuqezinjët renditen në vend të dytë në Grupin 2 në Ligën C me tre pikë, aq sa Skocia që kryeson grupin për shkak të golaverzhit, ndërkohë Izraeli qëndron në fund me 0 pikë.

Ndeshja nisi mirë për vendasit që pas 5 minutash lojë japin sinjalin e parë me anë të McGregor, por Strakosha pret pa vështirësi. Skocezët sulmojnë sërish dhe vetëm falë portierit kuqezinjët shpëtojnë nga gjuajtja e Mulgrew (10'). Në këto minuta Skocia dominon lojën, e cila është spostuar në gjysmefushën e Shqipërisë. Kuqezinjët i shpëtojnë vetëm shtylla, pas një gjuajtje të frikshme të Naismith gjatë ekzekutimit të një goditjeje dënimi nga McGinn (24'). 4 minuta për-



para fundit Skocia kaloi në avantazh me anë të Naismith, por arbitri sinjalizoi për pozicion jashtë loje.

Një minutë më pas kuqezinjët përgjigjen me Memushaj, i cili provon me një gjuajtje nga jashtë zonës, por

nuk ka shënjestrën e duhur dhe kjo pjesë u mbyll me rrjeta të kundërshtarit, por nuk kanë efikasitet përpara.

Pavarësisht disa aksioneve të rrezikshme, ndeshja u mbyll me suksesin e Skocisë që debutoi me fitore në Ligën e Kombeve. Me të nisur pjesa e dytë Panuçi bëri zëvendësimin e parë duke hedhur në fushë një mbrojtës si Prenga, për një mesfushor sulumues si Grezda. Gjithsesi zëvendësimi nuk rezultoi i suksesshëm, pasi Naismith e shfrytëzoi në maksimum krosin e Robertson dhe me kokë gjuan drejt portës. Topi fatkeqsisht përplaslet me Gjimshitin dhe përfundon në rrjetë (47'). 4 minuta më vonë kuqezinjët kanë mundësinë më të mirë për të barazuar ndeshjen, por Balaj ndalet nga McGregor, që bëri një pritje të shkëlqyer duke e dërguar topin në këndore. Në aksionin e radhës Lilaj provon me një gjuajtje të fortë nga distanca, por sërish McGregor i thotë jo golit

(53'). Në disavantazh kuqezinjët hidhen në kërkim të golit të barazimit dhe Balaj ka sërish një tjetër mundësi të shkëlqyer, por nuk arrin të shfrytëzojë topin e servitur nga Ndoji (66'). Në aksionin e radhës, skocezët fitojnë një goditje këndi dhe shënojnë golin e dytë. Naismith përfitoi nga dalja e gabuar e Strakoshës dhe me një gjuajtje të fortë me kokë dyfishoi shifrat (68'). Skocia kontrollon lojën dhe i afrohet golit të qetësisë, por Strakosha e pret pa vështirësi gjuajtjen e Armstrong (72'). Në minutat e mbetura kuqezinjët i afrohen më tepër portës së kundërshtarit, por nuk kanë efikasitet përpara. Pavarësisht disa aksioneve të rrezikshme, ndeshja u mbyll me suksesin e Skocisë që debutoi me fitore në Ligën e Kombeve.

TRAJNERI I SHQIPËRISË

Panuçi: Jemi dobët në 20 metrat e fundit, pësojmë gola naivë

Trajneri Shqipërisë, Panuçi, ka thënë ndër të tjera pas ndeshjes se Shqipëria është shumë e dobët në 20 metrat e fundit. Ai deklaroi se Shqipëria duhet të jetë më agresive.

Kundërshtari na dominol. Ishte përgatitur keq ndeshja?

Është mendimi juaj, unë kam mendimin se ndeshja është përgatitur mirë. Kemi dhuruar dy gola. Kemi pasur rastet tona, por ata shënuan, ndërsa ne nuk shënomim dot.

Duhej eksperiencia e Bashës sot? Edhe mbrojtja ndryshoi në pjesën e dytë...

Ne kemi limitet tona në aspektin defensiv. Kundërshtari na ngacmon për të shkuar në zona e golit, dhe ne i japim hapësirë. Kemi pasur rastet tona, por në fushë ka pasur edhe lojtarë të tjerë me eksperiencë.

MBROJTJA...

Vuajtëm shumë në pjesën e parë, dhe mendova të shkojmë me 3



mbrojtës. Jemi shumë të mirë, të përzemërt për të na shënuar. Kundërshtari është shumë i ashpër kur shkojmë t'i shënojmë, ndërsa ne jemi shumë të hapur.

Një arsye pse nuk luajtëm Bashën?

Nuk vlen vetëm një lojtar kundër cilësisë, ligësisë, apo ashpërsisë së kundërshtarit. Kundër Turqisë, kur fituam të gjithë tatë "bravo Lilaj". Ne jemi shumë të dobët në 20 metrat e fundit.

Thatë që keni ardhur për të fituar, si mund të fitojë një skuadër që goditjen e parë e bën në minutën e 58-të?

Është për ta luajtur gjithë grupin. Kemi gotën gjysmë plot. Nuk jam dakord që rasti i parë ishte në

minutën e 58. Kishim rastin me Memushajin. Kemi limitet tona. I kemi lënë hapësira kundërshtarit në momentet kur na shënoi.

Kush është ekuilibri që duhet të rrijë Shqipëria?

Unë nuk jam euforik. Jam koshient për limitet dhe defektet tona. Do të sforcohemi shumë nëse nuk arrijnë të përformojmë këto pika.

Deri ku mund të arrijë Shqipëria në këtë grup?

Kemi probleme të mëdha në mbrojtje. Duhet të rregullojmë mbrojtjen. Duhet të jemi shumë të ashpër në mbrojtjen. Nuk e di çfarë do të ndodhë me grupin, por duhet të jemi shumë të fortë në fazën mbrojtëse.

TRAJNERI I SKOCISË

Meklish: Fituam ndaj një skuadre të fortë

Trajneri i kombëtares skoceze, Aleks Meklish u shpreh se fitorja e skuadrës së tij ishte totalisht e merituar dhe pavarësisht se Shqipëria është një skuadër e fortë, lojtarët e tij ishin në maksimum përgjatë gjithë 90 minutave. Pas ndeshjes, Meklish tha:

Fitorja kundër Shqipërisë

"Nuk krijuam shumë raste, por e dinim se sa më shumë të ushtronim pre-



merituam me patjetër fitoren, pavarësisht se në disa raste u vumë në presion".

SHQIPËRIA E DOBËT:

"Ne e respektojmë Shqipërinë dhe iu thashë lojtarëve të mi të respektojnë kundërshtarët dhe të luajnë lojën e tyre më të mirë, pasi vetëm kështu mund të fitonim. Ata janë një skuadër shumë e fortë, por ne bëmë një lojë shumë sulumuese në fillim të takimit. Kjo gjë e na dha fitoren", u shpreh Meklish.

MESFUSHORI NUK BINDI

Lilaj: Ishte një rezultat zhgënjyes!

Mesfushori Sabien Lilaj startoi si titullar në formacionin e Panuçit në ndeshjen kundër Skocisë, madje luajti për 90 minuta, ku ishte dhe një nga më të mirët. Pas ndeshjes, mesfushori tha:

Si erdhi kjo humbje:

"Nuk është e thjeshtë që në një stadium si ky dhe me një lojë tradicio-

nale skoceze, e dinim që në pjesën e parë do të ishte shumë e vështirë. Në pjesën e dytë u ndëshkuam dhe ai gol i shpejtë na demoralizoi".

Titullar për 90 minuta:


"Luajtëm për 90 minuta dhe ishte diçka pozitive për mua, por më vjen keq për rezultat. Kisha mundësi më shumë që ta ndihmoja skuadrën, pasi edhe mund

të kisha shënuar, por nuk qe e thënë".

Ndryshimet e pjesës së dytë:

"Luajtëm ndryshe në pjesën e dytë, kjo ishte zgjedhja e trajnerit dhe ne zbatuamë detyrat. Na kërkoi të mbajmë kokën lart përgjatë gjithë takimit dhe ne u munduam, por ishim të pafat", u shpreh Lilaj.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Eshhtë babëzia.
8. Burton regjisor.
11. Skllavija e Abrahamit.
12. Një ditë në mbledhje.
14. Tyson i boksit.
15. Rrethojnë ringun.
17. Beson pa kufij.
19. Zola që shkroi Nana.
20. Eshhtë ankimum.
23. Pak elementarë.
24. Janë me para në bankë.
26. Matet pa kufij.
27. Janë ngrehina për reparte fabrikash.
28. Një zog i verdhë.
29. Inicialet e Moravia-s.
31. Oytet gjerman.
34. Një zonjë që ha gurë.
35. Pak analogji.
36. I ka plasur të paturpit.
37. Janë legjendat.

38. Nuk ka akoma një bebe.
39. Fillojnë mirë.
40. Janë brinjë në skuadër.
42. Shkruhet i shtati.
44. Nget edhe ajo e mirë
47. Mbahet në gisht.
48. Janë numrat 1, 3, 3...

VERTIKAL

1. Kanë shpatë të tilla.
2. Janë edhe ato polare.
3. Janë mizorët.
4. Janë male në Rusi të tilla
5. Eshhtë nusja me vello.
6. Një rreth pa ekstreme.
7. Mbyllin kuvendin.
8. Në kryt të titujve
9. Diku në qendër.
10. Markë cigaresh.
13. Janë rrëfimet e të pandehurit.
14. Janë penjtë për gjergjef.
16. Mbarojnë fare.
18. Janë stitët e... provimëve.
20. Mund të jenë fotografikë të tilla.
21. Vitet pa kufij.
22. Një fjalë për tutje.
24. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
25. Eshhtë e akuzuara... injorante
26. Baldwin aktor
27. Një pjesë e kandidatëve.
28. Krenar pa çift.
30. Grazia Cucinotta.
32. Paul këngëtar.
33. Janë pëshjtjellat.
35. Inicialet e Moravia-s.
37. Pak makinacione.
38. Samuel bomber kamerunas.
40. Markë makine koreane.
41. Ente Kombëtare Durrës.
42. Fillojnë kurat.
43. Inicialet e Zemeckis regjisor.
45. Ekstreme në litar.
46. Fillojnë lejen.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

1. Satelit i Uranit.
6. Eshhtë edhe ai i Pallës.
11. Tiran pa kufij
12. Në krye të armatës.
13. Një Ibrahim violinist.
14. Qendër ditore.
15. Mund të jenë fotografikë.
17. Inicialet e Einstein.
18. Një mbishkrim në kryq.
20. Janë si vite.
21. Thurman aktore.
22. Të parat në irritim.
23. I preu Seneka.
25. Fillojnë ilustrimet
26. Isaac Asimov.
27. Një Vladimir kompozitor.
28. Janë në modë.
30. Janë zyrat... qeveritare
32. Me të nxjerrin trarë.
35. Një shkop, thupër.


37. Eshhtë Shqipëria e madhe.
39. U thyen në Salamina.
40. Një raport shumë i ngushtë.
41. Nota e diapazonit.
42. Fund heroi.
43. Një top në rrjetë.
45. Gjysma alarmi.
46. Herët pa zë.
47. Sampras i tenisit.
48. Me to bëjnë triko.
49. Një gjuajtje futuritmihi në tenis.
50. Janë kokrrat e lisit.

VERTIKAL


1. I famshëm ai i Sizifit.
2. Mund të jetë e hollë dhe therëse.
3. Fillojnë rastësisht.
4. Një pjesë e napolitanëve.
5. Janë situatat e rrezikshme para portave.
6. Mund të jenë kundërajtore.
7. Lindin në kokë.
8. Gjysmë shtëgu.
9. Hiden të parat.
10. Eshhtë njeriu i përsosur.
13. Një fjalë për tutje.
15. Fundi i një samurai.
16. Mbyllen me epilog.
17. Bel i maupassant.
19. Inicialet e Redford.
23. I manifeston nxënësi i papërgatitur.
24. Në hyrje të tokës.
26. Pak impresioniste.
27. Janë metrat në sipërfaqe
29. Hapet një për ajër.
30. Gjysmë krenar.
31. Një hidrokarbur.
33. Vrau Hektorin.
34. Një film i rixhiruar.
36. Kupat pa kufij.
38. Inicialet e Nolte aktor.
41. Ullmann aktore.
43. Një brilantinë moderne
44. Hotel pa kufij.
46. Ekstremë në hall.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËNGJIGJET E FJALËKRYEQVE TË NUMRIT TË KALUAR

K	O	P	E	R	T	I	N	A	T	E	B	A
G	O	M	A	R	K	N	L	L	A	T	O	M
L	A	L	O	S	D	E	B	I	M	E	T	
L	A	S	H	P	R	I	P	A	R	I	M	
A	L	S	K	O	L	O	N	E	T	M	A	
P	A	R	A	Z	I	T	E	O	D	E	T	
E	M	I	R	A	T	I	U	R	A	T	E	
G	I	P	A	K	A	T	I	R				
A	S	M	A	U	R	E	E	N	T	E	I	
B	A	Z	A	T	E	D	P	E	M	A		
I	R	A	N	A	T	L	E	T	K	I	L	
M	I	R	I	A	M	A	T	A	M	A	N	E
P	A	P	A	R	A	Z	Z	O	T	H	I	
A	N	E	T	A	R	P	A	G	E	S	A	T
P	A	R	M	A	K	N	O	T	A	R	E	
A	T	L	S	A	H	G	A	R	A	T		
S	E	A	K	A	T	E	G	O	R	I	K	E
M	K	A	P	I	T	A	L	I	I			
M	A	N	I	P	U	L	T	M	E	A	R	O
A	T	L	O	N	M	E	T	A	L	I	K	
A	S	E	T	I	M	E	S	R	E	T		
K	A	M	P	E	R	E	T	A	P	E		
A	R	I	E	B	A	L	E	R	I	N	A	T
T	A	L	L	J	A	E	R	A				

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

SUDOKU

	3		7		6			
			8					3
	5				1			
5			4		8			
	6				9			
	7		9	1				6
			6	5				
6		1					4	9
4	2	3						7

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	7	8	3	5	1	4	6	9
1	3	9	4	2	6	5	7	8
4	5	6	7	8	9	3	1	2
5	9	3	6	1	4	8	2	7
6	8	4	9	7	2	1	3	5
7	1	2	8	3	5	9	4	6
8	2	7	5	4	3	6	9	1
9	4	5	1	6	7	2	8	3
3	6	1	2	9	8	7	5	4

Argëtim filozofik

- Një ëndërr bëhet objektivi kur ndërmerren veprime për realizimin e saj.
- Udhëtimi, ashtu si dashuria, është një përpjekje për ta kthyer ëndërrën në realitet.
- Të premtori vetëm atë që mund të realizoni. Të realizoni më shumë se sa premtori.
- Dikur njerëzit studiojnë për të përsosur veten e tyre. Tani studiojnë për të shkakuar admirimin e të tjerëve..
- Vetëm në ëndërrat tona jemi të lirë. Pjesën tjetër të kohës kemi nevojë për pagat.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

1	K	U	7	L	2	T	14	4		9	7	4	19
8	10	5		1	4	12	2	6	7	5			10
10	4	7		4	1	2	8	10	6	4	7	5	
18				1	7	5	8	9	4	2	10	4	
6	5	1		6	2	10	5	2	5			12	
7	1			17	5		1	5	10	17	4	2	
2	5	10	17	4	2		4	10	10	6	15	5	
8		2	8	12		15		6	10	17	5		
18	10	5	16	19		6		4	8		10	1	
6		7	5		6	11	5		9	19	6	7	
4	11	4	7	6	2	6	1	5		7	17	6	
12	5	2	5		12	1	6	15	4	2			8

Q	E	L	Q	T	I	M	E	L					
A	H	E	K	U	R	U	D	H	O	R	E		
R	L	P	E	L	I	K	A	N	I	M			
K	H	E	L	I	K	O	P	T	E	R	E		
M	N	T	P	Z									
Q	U	I	E	A	A	L	E	D	T				
I	Z	A											
L	I	T	A	R	E	T	S	I	T	A			
I	K	O	N	A	T	K	A	L	A	M	A		
M	A	M	S	A	N	T	I	K	T				
I	I	R	O	N	I	K	O	A	Z	I			

Thënie të mençura

- Asnjë ëndërr nuk bëhet realitet në mënyrë magjike. Duhet djersitje, dëshirë dhe punë e vështirë.
- Realiteti mund të shkatërrojë ëndërrën. Pse nuk mundet ëndërra të shkatërrojë realitetin?
- Ëndërrrojnë në flitrim, por në martesë zgjojnë.
- Dhuna maskohet vetëm me gënjeshtër, dhe gënjeshtër mbahen vetëm me forcë.

